

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7721 E hënë 26 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Dje** në 'Deutsche Welle'  
Presidentët dhe kryeministrat e 27 vendeve të mbetura të BE e kanë miratuar marrëveshjen me Londrën. Një problem i madh mbetet nëse marrëveshja do të...  
Vijon në faqen 19

**Çfarë parashikon Brexit-i?**



**Opinion** i Ditës  
Demokracia liberale është sot një realitet superior, që ka sfiduar me efikasitet të gjitha format e modelet e tjera, me standardet e treguesit esencialë të lirisë...  
Vijon në faqet 20-21

NGA VASIL KURETA  
Demokracia liberale e kërcënuar nga një autoritarizëm i ri  




Në 2013, qeveria prokuroi tri segmente me vlerë 5.82 mld lekë

## Skandali, segmenti i Unazës së Re, 5 herë më i kushtueshëm se tri akse të tjera

Dita e 22 e protestës, lirohen 10 të ndaluarit. Basha: Sot publikojmë faktet se sa e madhe është vjedhja

Nga GJERGJ EREBARA

Ministria e Transportit u përpoq të argumentojë të lenjten shkaqet se pse 2.3 kilometra autostradë po kushtojnë bashkërisht mbi 40 milionë euro. Ajo tha se ka mbikalime dhe vepra arti. Por në Tiranë janë ndërtuar edhe tre segmente...  
Në faqet 2-3

## LIGJI I RI NE KUVEND, HARTA KADASTRALE DO PUBLIKOHET PER KONSULTIM PUBLIK

# SI DO TE BEHET REGJISTRIMI I PRONES, DOKUMENTET QE DUHEN

ASHK do të bëjë verifikimin në terren para përgatitjes së kartelave të pasurive. Shkrihen Hipotekat dhe ALUIZNI, administrata e tyre edhe 6 muaj punë



(Në foto) Foto ilustruese

MIKU I ERVIN MATES  
Vrasja në Bllok, vetëdorëzohet në policinë e Tiranës Ajaks Boshnjaku  
Në faqen 9

ISH-KREU I LAZARATIT  
Zgjedhjet në PD, Dashamir Aliko në krye të demokratëve të Gjirokastres  
Në faqen 5

SHIFRA REKORD  
Gjermania jep 164.4 milionë euro për Shqipërinë, Schütz: Provë e mbështetjes  
Në faqen 8

NGJARJA NE TIRANE  
Arrestohet i dehur në timon portieri i "Partizanit". Nesër masa për Alban Hoxhën  
Në faqen 22

LISIEN DAMINI: NISMA DO TE VAZHDOJE



Studentët e "Lvarasi" pranë familjeve në nevojë, ndihmë me veshje dhe ushqime  
Në faqen 11

Mjeku i përgjithshëm: Fëmijët dhe të moshuarit, kategoritë më të riskuara

## Gerald Kola: Të shpëtosh nga gripi brenda pak ditësh

Ylli Merja: Si të kuron diabetin me çajin bimor, efektet e mrekullueshme

Nga VOLTIZA DURO

Gripi është një sëmundje virale, në dukje e padëmshme, por që ka shkaktuar miliona viktima në historinë e njerëzimit. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku Gerald Kola thekson



se gripi nuk duhet trajtuar si një gjendje kalimtare. Ai bën me dije se një kujdes i veçantë duhet treguar ndaj personave me imunitet të dobët si fëmijët e vegjël (0-12 vjeç); moshë e tretë (mbi 60 vjeç) dhe personat që vuajnë nga sëmundjet kronike...  
Suplement

# UNAZA E MADHE PROTESTA

Dita e 22 e protestës së banorëve tek Astiri, reagimet e politikës

## Basha: Sot publikojmë faktet se sa e madhe është vjedhja

*"Rama duhet të tërhiqet urgjentisht nga ky projekt"*

Banorët e zonës së Astirit në kryeqytet, të cilët preken nga Unaza e Re kanë dalë sërish në protestë në ditën e 22. Në mbështetje të banorëve ka qenë edhe kreu i PD, Lulzim Basha, i cili tha se të hënën PD do publikojë fakte të reja për projektin që ai e quan korruptiv. Sipas Bashës, policia ka dhunuar qytetarët të cilët protestojnë për të drejtat e tyre duke mos kursyer as të miturit. Basha tha se banorët e kanë kuptuar vjedhjen që po u bëhet dhe nuk do pranojnë më as dëmshpërblimet për banesat e tyre. "Është një provë e qeverisë së Edi Ramës, dhe i mban qytetarët si të burgosur politikë dhe liron kriminelët. Nesër do të publikojmë fakte tronditëse se sa e madhe është kjo vjedhje. Arrestimi dhe keqtrajtimi 12 qytetarëve nuk duhet të mbetet jashtë vëmendjes së medias. Kanë rrahur dhe dhunuar një 17-vjeçar dhe imagjino se çfarë ka ndodhur me të tjerët. Edi Rama duhet të tërhiqet urgjentisht nga ky projekt megavjedhje. Prokuroria nuk ekziston, nuk ka, se po të kishte prokurori ky djalë që u rrah, ata që e rrahën do kishin frikë nga prokurorët. Është i njëjti segment, i pari është ndërtuar me 8 mln euro për km, ky tani do ndërtohet me 20 mln euro për km. Është një vjedhje ashiqare, 20 mln euro/km. Një nga kompanitë këtu është regjistruar në parajsë fiskale. Edi Rama që të vjedhë këto paratë, kërkon të nxjerrë këta njerëz nga shtëpitë. Ata kanë marrë një vendim besoj e kenë marre vesh. Ata nuk do pranojnë më asnjë përçapje të mëtejshme dhe do mbrojnë shtëpitë e tyre. Nëse më përpara banorët flisnin për dëmshpërblime, tani ata e kanë kuptuar që kjo është një vjedhje që nuk bëhet për qytetin, por për të mbushur xhepat e Ramës. Ata do mbrojnë me çdo kusht vatrën e tyre", tha Basha. Në mbështetje të banorëve janë edhe deputetë të tjerë nga opozita, midis të cilëve deputetet e LSI-së: Endrit Braimllari, Kejdi Mehmetaj, Klajda Gjoshja, Floida Kerpaci, Nora Malaj dhe këshilltarja e LSI në këshillin bashkiak Tiranë, Erisa Xhixho.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

18

### TË PLAGOSUR

Janë 18 të plagosur në total mes të cilëve tre nga radhët e protestuesve. Më rëndë nga të gjithë të plagosurit është efektivja 24-vjeçare e 'Shqiponjave', e cila humbi menjëherë dy gishta nga një shashkë, e cila iu hodh në dorë. Gjendja momentale e policës është nën kontroll, ndërsa u dërgua jashtë shtetit për një shërbim më të specializuar.



Banorët e Unazës së Re gjatë një proteste

### BANORËT E UNAZËS SË RE GJYKUAR PËR VEPRIME TË DHUNSHME

#### DETYRIM PARAQITJE

1. Fluturim Goleci,
2. Amarildo Sinanaj,
3. Marsel Velillari,
4. Ruzhdi Daci
5. Shpati Bilbilaj,
6. Erald Muçaj,

7. Ali Nalic,
8. Alban Ahmetcenaj
9. Paolo Ahmetcenaj
10. Lulzim Dozhanin

#### ARREST ME BURG

11. Dorjan Protoduari

### "Psikologu ishte inekzistent. Isha i frikësuar"

## 17-vjeçari: Si më rihnin me shpulla policët në komisariat

Paolo është vetëm 17-vjeç dhe është një ndër të shoqëruarit gjatë protestës së banorëve të zonës së Astirit në kryeqytet. 17-vjeçari ka folur gjatë protestës së sotme në prani të kreut të PD Lulzim Basha dhe ka thënë se është dhunuar nga policët brenda dhe jashtë komisariatit. "Më morën vetë, nxirrën telefonin me foto e njëh këtë, më gjuanin me shpulla. Në momentin kur me kanë shoqëruar i kam komunikuar që jam 17-vjeç. Gjatë shoqërimit nuk kam pasur dhunë, por në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë ka qenë komplet tjetër. Aty ka pasur dhunë. Një person ka qenë që më ka goditur para kamerave, ndërsa dy persona të tjerë kur isha brenda në zyrë. I thashë avokatit, në fakt, më mori një nga oficerët,



tjetri thoshte lërë se na hap punë ai se është i vogël. Kur po përgatishnin fletë-arrestin më thanë ke problem t'i thash avokatit për dhunë nga policia. Jo i thashë, sepse më shikonin të gjithë egër dhe s'kisha guxim. Kam qenë duke u dridhur. Psikologu ka

qenë thuasë inekzistent. Ia kam thënë psikologut të dytë, sepse u ndërruan. Ti je cub, je tregu në momentin e gabum, do dënohesh më e pakta 10 vite burg. Nuk ka pas kush me të pa shenjat", u shpreh ai.

Qëlloi me këpuçë Edi Ramën në spital, gruaja: Burrit i kanë thyer krahun, e kanë dhunuar

Nga përlshja e të enjtes së kaluar para godinës së parlamentit mbetën të lënduar 15 efektivë të policisë, mes tyre edhe efektivja 26-vjeçare, Ina Nuka, e cila humbi dy gishta e dorës së djathtë pas shpërthimit të kapsollave të hedhur nga protestuesit. Ndërkohë jashtë gjykatës familjarët e personave të arrestuar, banorë të Unazës së Re kërkojnë lirimin e tyre duke akuzuar kryeministrin. Gjykata e Tiranës ka lënë në burg për 30 ditë autorin e këpuçës ndaj kryeministrit Edi Rama. Gruaja e Ilias Sketirajit tha se ishin banorë prej 20 vitesh të Unazës së Re dhe se janë në proces legalizimi. Si shumë banorë të tjerë ajo deklaroi se ka paguar taksat ndërsa akuzoi policinë se i ka dhunuar burrin dhe fëmijët. "Kemi mbi 20 vite të Unaza e Re. Jemi në proces legalizimi. Kemi paguar taksat. Policia më ka dhunuar burrin e fëmijët", tha gruaja e Sketirajit. Ajo është shprehur se Policia e Shteti ka dhunuar burrin e saj duke i thyer krahun, por pre e dhunës sipas saj kanë rënë edhe fëmijët e saj. Gjithashtu, bashkëshortja e Sketirajit, i cili u la në burg për 30 ditë pas goditjes me këpuçë drejt kryeministrit theksoi se shtëpitë do t'i mbrojnë me gjak. "Burrit tim i ka thyer krahun policia, fëmijët e mi kanë qenë të dhunuar nga policia. Ne shtëpitë do t'i mbrojmë me gjak. Ky vendim është me urdhër të Ramës. Burri im nuk kishte as armë dhe asgjë. Pse duhet ta dënojë burrin tim me 1 muaj. Unë edhe jetën kam për ta dhënë. Ai acaror situatën. I bëj thirrje të mos lozë me zjarrin se do të digjet", tha ajo. Episodi ndodhi më 22 nëntor në Spitalin e Traumës ku kryeministri Edi Rama kishte shkuar për të parë gjendjen e policës së dëmtuar më rëndë Ina Nuka por edhe të efektivëve të tjerë. Pasi doli nga spitali, Sketirajit bashkë me banorë të tjerë që kishin të afërmit në spital hodhën thirrje e akuzë ndaj tij. Më pas Sketirajit qëlloi me këpuçë në drejtim të kryeministrit, por u ndalua nga policia.





Në vitin 2013, qeveria prokuroi tre segmente me vlerë 5.82 mld lekë

# Segmenti i Unazës së Re, 5 herë më i kushtueshëm se të tjerët

“2.3 kilometra kushtojnë bashkërisht mbi 40 mln euro”

Gjergj Erebara

Ministria e Transportit u përpoq të argumentojë të enjten shkaqet se pse 2.3 kilometra autostradë po kushtojnë bashkërisht mbi 40 milionë euro. Ajo tha se ka mbikalime dhe vepra arti. Por në Tiranë janë ndërtuar edhe tre segmente të tjerë të unazës të cilat kanë kushtuar krahasimisht më lirë.

Në vitin 2013, qeveria shqiptare e përbërë nga PD dhe LSI, prokuroi tre segmente të Unazës së Madhe të Tiranës me një gjatësi totale prej 12 kilometrash dhe me vlerë totale të tenderuar prej 5.82 miliardë lekësh (afërsisht 46 milionë euro me kursin e sotëm të këmbimit) ose një kosto për kilometër prej 4.9 milionë eurosh.

Të tre tenderët në fjalë u hetuan për kufizim të mundshëm të konkurrencës të kryer përmes një procedure që teknikisht njihet si “tender me rotacion”. Hetimi i Autoritetit të Konkurrencës erdhi pas një njoftimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili kishte konkluduar se përveç kufizimit të konkurrencës, në këto tenderë kishte potencialisht veprë penale, për të cilat KLSH njoftoi Prokurorinë e Tiranës.

Njësoj si në rastin e tre tenderëve të fundit të organizuara nga qeveria aktuale, ajo që i bëri këto tenderë të futeshin nën hetim nga Autoriteti i Konkurrencës ishte koncepti i “afirmesisë me fondin limit”.

Pavarësisht se të tre tenderët përbënin një rast studimor për manipulimin e tenderëve në këtë mënyrë, fakti është që rezultati i tyre mbartti kosto së paku tre herë më të ulët për kilometër se sa tre tenderët të tjerë të zhvilluar muajin e kaluar për ndërtimin e mbikalimeve dhe nënkalimeve në segmentin e Unazës së Pallati me Shigjeta deri te rrethorullimi “Shqiponja”.

Shqetësimi mbi koston e pazakontë të segmentit aktual me gjatësi 2.3 kilometra dhe me çmim të tenderuar prej 40 milionë eurosh ka shkaktuar debat politik së fundmi, ku Partia Demokratike dhe Lëvizja Socialiste për Integrim kanë argumentuar se tenderët janë dukshëm të manipuluar.

“Një hajdutëri dhe grabitje nga më të frikshmet,” e konsideroi Petrit Vasili nga LSI.

Kryeministri Edi Rama u



përgjigj në Twitter duke argumentuar se rrugët nuk krahasohen dot “si pantallonat teritale”.

Ministria e Transportit argumentoi nga ana e saj se segmenti aktual ka shumë mbikalime dhe nënkalime, të njohura në gjuhën teknike si “vepra arti” dhe që sipas transporteve, justifikojnë çmimin aktual prej 40 milionë eurosh.

## TENDERËT RROTACION

Tenderët për ndërtimin e segmenteve jugore dhe juglindore të Unazës së Tiranës u zhvilluan në vitin 2013. E gjithë puna për ndërtimin e 12 kilometrave u nda në tre lote. Në tenderë morën pjesë nëntë kompani, të cilat u bashkuan në tre oferta të njohura si “bashkime të përkohshme”. Të tre grupet e kompanive fituan secila nga një segment. Secili tender përfundoi me ofertën fituese fare pranë fondit limit ku në secilin tender, dy kompani hodhën oferta humbëse.

Segmenti i parë u fitua nga kompania Gener 2 me ofertë fituese të barabartë me 99.82% të fondit limit prej 1.96 miliardë lekësh. Bashkimi i operatorëve Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria hodhën një ofertë humbëse të barabartë me 99.91% të fondit limit, ndërsa kompania Albavia hodhi ofertë të barabartë me 99.96% të fondit limit.

Në segmentin e dytë, doli fitues konsorciumi Albavia & Favina & Alpin, me ofertë fituese të barabartë me 99.99% të fondit limit prej 1.94 miliardë lekësh. Konsorciumi Gjoka Konstruksion & Gjiguria hodhi ofertë humbëse të barabartë me 99.98% të fondit limit ndërsa Gener 2 hodhi ofertë prej 99.99%.

Në segmentin e tretë doli fitues Gjoka Konstruksion

dhe Gjiguria me ofertë fituese 99.9% nga limiti prej 1.93 miliardë lekësh. Në këtë garë hodhi ofertë vetëm Albavia me çmim të barabartë me 99.95%.

Opozita duket se përdor pikërisht këto argumente që vijnë nga fusha e ekonomisë për të thënë se tre tenderët për segmentin aktual të Unazës janë dukshëm të manipuluar.

Në tre tenderët e zhvilluar për tre lote në projektin aktual, një kompani konkurroi në secilin rast pa garë. Në dy tenderë, ofertat fituese ishin të barabarta me mbi 99.8% të fondit limit.

Të dhënat për tenderin e tretë nuk gjenden në faqen e prokurimeve publike në internet APP.gov.

Të treja segmentet e unazës së Tiranës që sakaq janë ndërtuar kanë në përbërje mbikalime dhe nënkalime të shumta, si dhe një tunel të shkurtër në segmentin nga TEG për në Farkë, segment që është ende i papërfunduar.

Mbikalimi më i madh është ai të “Pallati me Shigjeta” ndërsa në të njëjtin segment ka mbikalime të tjera në Selitë, pranë Kopshtit Zoologjik, pranë Liqenit të Thatë, pranë fshatit Sauk e më tutje.

Afërsia e ofertës fituese me fondin limit konsiderohet në manuale të ndryshme të OECD apo Bankës Botërore si një ‘flamur i kuq’, një sinjalizues për autoritetet për rrezik të mundshëm korupsioni ose marrëveshjeje të fshehtë me kompani pjesëmarrëse në garë për të shmangur garën dhe për të maksimizuar fitimet e tyre.

100 lekë dhe oferta fituese është 99 lekë, atëherë autoritetet duhet ta konsiderojnë këtë rezultat si të dyshimtë. Arsyeya është se probabiliteti matematikor sugjeron që disa kompani që marrin pjesë në një garë, e kanë të pamundur të jenë të sigurt se askush nuk do të ofrojë një ofertë më të ulët për një veprë publike me përmasa të mëdha. Një tender normal konsiderohet pa dyshime për manipulime në rast se oferta fituese është nga 80 deri në 90% të fondit limit.

Problemi është se me të tre tenderët e qeverisë së kaluar për segmentin ekzistues të Unazës së Madhe të Tiranës ashtu edhe me tre tenderët e qeverisë aktuale, afërsia me fondin limit nuk është 1%, por shpesh, më pak se 0.1%.

## “FAKTOR NJERËZOR”

Autoriteti i Konkurrencës e mbylli pa masa ndëshkimi hetimin për mundësinë e kufizimit të konkurrencës në tre tenderët për unazën e Tiranës të zhvilluar në vitin 2013. Në vendimin e vitit 2015, autoriteti argumentoi se problemi në këtë rast mund të jetë shkaktuar nga “një sjellje njerëzore që tejkalon parashikimet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Autoriteti konkudoi se inspektimet e tij nuk kishin mundur të gjenden të mbledhin fakte për të provuar një marrëveshje të mundshme mes operatorëve me synimin e kufizimit të konkurrencës por shtoi se “është sjellja e Autoritetit Kontraktor ajo që e ka bërë procesin dyshues për manipulime të mundshme të procedurave të prokurimit, dyshime për të cilat ka nisur procedimi nga prokuroria e rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Prokuroria e Tiranës pati nisur hetime të tenderit në bazë të një kallëzimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Rezultati i hetimit nuk dihet. Vendimi i Autoritetit të Konkurrencës nuk ishte unanim. Komisioneri Koço Broka dha një opinion pakice. Ai argumentoi se pavarësisht se nuk janë gjetur prova konkrete për një marrëveshje të ndaluar, të gjitha faktet që tregojnë kufizim të konkurrencës janë të pranishme, përfshirë faktin që Gener 1 e fitoi tenderin me 99.82% të fondit limit, që Gjoka dhe Gjiguria e fituan me 99.91% të fondit limit dhe që Albavia & Favina & Alpin, e fituan me 99.87% të fondit limit.

## Seanca nën kushte të rrepta sigurie

### Lihen të lirë 10 nga banorët e Astir, një mbetet në burg

Gjykata e Tiranës lë të lirë 10 prej të arrestuarve pas protestës të parlamentit, ndërsa ka lënë në burg vetëm njërin prej tyre. Bëhet fjalë për Dorjan Protoduarin, i riu që u arrestua tek Spitali i Traumas pak orë pas protestës të parlamentit. Vendimi ka ardhur pasi trupi gjykoes ka dëgjuar prokurorinë dhe të arrestuarit me avokatët e tyre. Seanca është zhvilluar nën masa shumë të rrepta sigurie. Qindra efektive policie me dhe pa uniformë kanë qenë brenda dhe jashtë gjykatës ku po zhvillohej njëkohësisht protesta e familjarëve të tyre dhe banorëve të tjerë të Unazës së Re. Në seancë kanë marrë pjesë edhe deputetët e opozitës, të cilët fillimisht kanë debatuar me policinë pasi nuk ka pranuar t'i lejojë. Por më pas ata kanë hyrë në seancën për masën e sigurisë. Bëhet fjalë për deputetët e opozitës Aldo Bumçi, Edi Paloka, Ervin Salianji, Klajda Gjoshja, Kejdi Mehmetaj, Endrit Braimllari dhe Silva Caka.

Prokuroria kërkoi arrest me burg për 6 nga 11 të arrestuarit: Fluturim Goleci, Amariido Sinanaj, Marsel Velilari, Dorjan Protoduarin, Ruzhdi Daci si dhe për Shpati Bilbilajn. Ndërsa për 5 të tjerë: Erald Muçaj, Ali Nalic, Alban e Paolo Ahmetcanaj dhe Luzlim Dohanin prokuroria kërkoi detyrim paraqitje. Luzlim Dohanin, një prej të arrestuarve tha në seancë se nuk ka bërë asnjë të paligjshme vetëm ka mbrojtur shtëpinë e tij. Ai tha se e kanë arrestuar bashkë me gruan dhe djalin i tyre ka mbetur vetëm. Avokatët kërkuar lirimin menjëherë të 45-vjeçarit. “Jam arrestuar me gjithë gruan time. Nuk shkoja dot të merrja djalin 7 vjeç nga shkolla. Në na kanë çuar në komisarjat. Nuk na kanë lënë të komunikojmë me askënd. Djali ka shkuar në shkollë, e ka gjetur shtëpinë mbyllur, ka pasur frikë e ftohtë. Është ushqyer tek komshinjtë ne na kanë tërhequr zvarrë nëpër komisarjate e burgje”, tha Dohanin. Ndërkohë i arrestuari tjetër Ruzhdi Daci, i moshuar dhe babai i një djali 20 vjeç paratrapëgjik tha në gjyq se nuk i është paraqitur asnjë provë dhe duke qenë ish-ushtarak e di çfarë do të thotë element të veprave penale. “Nuk jam dakord me akuzën. Nuk më është paraqitur asnjë provë. Unë jam ushtarak në pension. E di se çfarë do të thotë element të veprave penale. Kërkoja të më nxjerrin prova filmike për akuzat ndaj meje. Më shoqëruan pasi më pandehin militant të PD”, tha Daci. Personat e mësipërm akuzohen për: “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve shpërthyes dhe i municionit”, Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme, por edhe për prishjen e qetësisë publike e kryer në bashkëpunim.



## CEREMONIA PËRKUJTIMI

U përruan dje në Prizren shtatoret e tre prej drejtuesve të Lidhjes

# "Lidhja e Prizrenit" bën bashkë Edi Ramën me Ilir Metën

Meta: Të forcojmë bashkëpunimin e të gjithë shqiptarëve

Në vigili të 140-vjetorit të mbajtjes së Lidhjes Prizrenit, patriotë, historianë, politikanë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare nderuan dje tri nga figurat kryesore që bënë të mundur mbajtjen e të parit organizim të mirëfilltë politiko-ushtarak shqiptar që pas kohës së Skënderbeut. Shtatoret e Ymer Prizreni, Abdyl Frashëri dhe Sulejman Vokshi do të qëndrojnë tashmë në oborrin e Kompleksit Monumental të Lidhjes së Prizrenit, si një dëshmi e përpjekjeve të popullit shqiptar për të mbrojtur identitetin dhe trojet shqiptare në një nga momentet më të vështira për ekzistencën e kombit tonë. Ceremonia e organizuar me këtë rast bëri bashkë krerët më të lartë nga Shqipëria dhe Kosova, të cilët në fjalët e tyre vlerësuan rolin që luajtën këto figura në një moment historik për fatet e kombit shqiptar. Në fjalën e tij përshëndetëse, presidenti Ilir Meta theksoi se kjo përkujtimore duhet të jetë një thirrje për bashkim të të gjithë shqiptarëve në funksion të prosperitetit të tyre. "Le të përfitojmë nga ky cast për të bërë thirrje të forcimit të bashkëpunimit, dhe të bashkimit të të gjithë shqiptarëve në interes të prosperitetit të kombit tonë, por njëkohësisht edhe të përpjekjeve të përbashkëta të të gjithë shqiptarëve për forcimin e perspektivës sonë europiane dhe të gjithë popujve të tjerë në këtë rajon", tha presidenti Meta. Ndërsa kryeministri Edi Rama duke iu referuar pikërisht fjalëve të Abdyl Frashërit, u shpreh se nuk do të jetë e largët dita kur të huajt të kuptojnë se shqiptarët janë një popull evropian. "Janë të shumtë smirëzënjtë vetëm ndaj faktit që ne ekzistojmë. Ata kërkojnë të na e grabisin mendimin e ekzistencës sonë. Le të mendojmë dhe të punojmë për vete dhe të mos ketë asnjë ndryshim mes toskëve dhe gegëve. Ne jemi të gjithë shqiptarë dhe formojmë një Shqipëri të bashkuar", - u shpreh Rama. Ndërsa



Dje në Prizren

### DEKLARATA

"Janë të shumtë smirëzënjtë vetëm ndaj faktit që ne ekzistojmë. Ata kërkojnë të na e grabisin mendimin e ekzistencës sonë. Le të mendojmë dhe të punojmë për vete dhe të mos ketë asnjë ndryshim mes toskëve dhe gegëve. Ne jemi të gjithë shqiptarë dhe formojmë një Shqipëri të bashkuar", - u shpreh Rama.

## Ish-ministri i PD u propozua për anëtar në Bordin e Bankës

### Rama: Boden e propozova si profesionist, jo që PD ta bënte tradhtar

Këshilli i Ministrave bëri publike dy ditë më parë tre emrat që i propozonte Kuvendit të Shqipërisë për t'u zgjedhur në Bordin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Natyrisht që mes tyre spikaste edhe emri i ish-ministrit të Financave, Ridvan Bode, i cili ngjalli shumë reageime, sidomos në kampin opozitar. Nisur pikërisht nga ky reagim, kreu i qeverisë, Edi Rama në rubrikën e tij në rrjetet sociale "Përgjigja ime" ka sqaruar propozimin e tij, ndërsa mohoi që ai të ketë ndonjë qëllim të veçantë, përveç faktit se vetë kandidatura e Bodes përbush më së miri kriteret për të qenë në këtë bord të rëndësishëm. "Ridvan Boden e kam takuar vetëm njëherë në jetë, pa asnjë lidhje me politikën, kur ishte deputet



i thjeshtë. Shumë kohë më pas kur në kabinet po përgatishim propozimet e qeverisë për tre anëtarët, i kam çuar një SMS interesimi për kandidaturën e tij. Ish-ministri i Financave është përgjigjur pozitivisht. Bode u shpall tradhtar nga partia e tij dje. S'do kisha humbur asnjë sekondë as për t'i dalë në mbrojtje ish-ministrit të PD, aq më tepër që Ridvan Boden nuk e kam propozuar për sa shumë ka luftuar politikisht kundër qeverisë tonë

dhe meje në parlament. S'e kam propozuar as për ta larguar si udhëheqës politik në fushata si në garkun e Korçës ku e hoqi PD. Arsyja e propozimit tim, dhe a e ka tradhtar ai partinë, apo partia atë, këtë debat bëjeni në klubin e SHQUP-it. Ndërsa BSH nuk është as e partive dhe as e kadrinjve" u shpreh Rama. Më tej ai theksoi se si Bode dhe Arben Malaj me profesionalizmin e tyre i bëjnë nder Bankës së Shqipërisë. "Të jesh i propozuar për të kontribuar në bordin e BSH, duhet thjeshtë të jesh një profesionist. Arben Malaj dhe Ridvan Bode janë dy ish-ministra, sot jashtë rolit partiak, por kur vjen puna të proceset vendim-marrëse të BSH, janë dy figura të vlefshme në shërbim të politikës monetare të vendit tonë", -tha Rama.

jonë ajo do të bëhet realitet. Kushdo që dyshon se ne nuk do ta ndjekim rrugën përpara dhe nuk do të dimë të marrim veprimet e duhura, gabon", -tha Haradinaj. Edhe kryetari i Kuvendit të Kos-

ovës, Kadri Veseli, apeli që sakrificat e të parëve nuk duhet të lihen në harrësë, por duhet respektuar dhe çuar deri në fund. "Jemi të përgjigjshëm dhe të vëmendshëm për atë sakrificë që e



Haradinaj, Rama dhe Meta dje gjatë ceremonisë në Prizren



Vasil Rama gjenjshetar, Boden më parë e ka paditur në prokurori

Kreu i Grupit Parlamentar të LSI-së, Petrit Vasil ka komentuar propozimin e Ridvan Bodes në Këshillin Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Përmes një postimi në rrjetin e tij social "Facebook", Vasil nuk kursen akuzat ndaj kryeministrit Edi Rama të cilin e cilëson si gjenjshetar të korruptuar. "Kur ky kryeministër i patur padiste në prokurori dikur ish - ministrin Bode isha i bindur që bënte estradë dhe nuk besoja asgjë që thoshte. Isha i bindur që ishte gjenjshetar! Isha i bindur që ishte i pacip! Isha i bindur edhe që ishte i korruptuar! Dje e padiste në prokurori Boden për kredinë e rrugës Durrës - Kukës, e padiste në prokurori Boden edhe për privatizimin e OSSH, e akuzonte Boden edhe për lotarinë kombëtare, e bënte Boden fajtor edhe për greminën financiare dhe borxhin 700 milionë euro, por sot e propozon për këshillin e Bankës Shqiptare. Ky është turpi që qeveris vendin", -shkroi Vasil.

kemi pasur dje, sakrificë që e kemi dhënë nga familjarët tanë, nga të afërmit tanë dhe në të njëjtën kohë për të çuar përpara këtë amanet të heronjve dhe martirëve të Kosovës", nënvizoi Veseli. Kjo



Mbledhja e përbashkët e qeverive në Pejë, ja vendimet që do merren

Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës pritet të zhvillojnë sot një mbledhje të përbashkët në Pejë. Heqja e roaming dhe tarifës së shërbimit rroming, në kuadër të telekomunikimit ndërmjet dy shteteve. Bashkimi Evropian u ka kërkuar të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor që të heqin këtë tarifë, si formë lehtësimi për komunikimet në mes qytetarëve. Ky do të jetë takimi i pestë i përbashkët të dy qeverive. Herën e parë ato mbajtën takim të përbashkët në Prizren, në vitin 2014, ndërsa një vit më pas, në Tiranë është mbajtur takimi i dytë. Takimi i tretë në Prishtinë, kurse vitin e kaluar është mbajtur në qytetin e Korçës. Ndërkohë qyteti i Pejës është veshur kuqezi me rastin e festave të nëntorit, por edhe takimit të përbashkët të dy qeverive.

ceremoni u zhvillua një ditë para mbledhjes së përbashkët që dy qeveritë shqiptare dhe kosovare do të mbajnë në Pejë përpara festave kombëtare të Pavarësisë dhe Çlirimit.





Lista me emrat e kryetarëve të rinj demokrat të zgjedhur këtë fundjavë

# Zgjedhjet, Dashamir Aliko në krye të PD-së së Gjirokastrës

## Në Korçë është konfirmuar Andrea Mano

Kanë prodhuar jo pak surpriza zgjedhjet e brendshme në Partinë Demokratike. Këtë fundjavë demokratët kanë mbyllur zgjedhjet për kryetar të degëve në afro gjysmën e bashkive, ndërsa pritet që i gjithë procesi të mbyllet fundjavën e ardhshme. Deri më tani nuk kanë munguar surprizat, ku veç Ferdinand Xhaferit që u konfirmua në Durrës, një tjetër emër që ka rënë në sy ka qenë edhe ai i kryetarit të ri të PD-së në Gjirokastrë, Dashamir Aliko. Ai është një emër i njohur jo vetëm për demokratët, por për gjithë opinionin publik, pasi më parë për shumtë vite ka drejtuar ish-komunën problematike të Lazaratit. Pas dorëheqjes së Roland Bejkos, Aliko rezultoi fitues me diferencë të ndjeshme votash ndaj rivalit Gjergj Dudi. Nga votimet e delegatëve të Partisë, Aliko ka marrë 166 vota kundrejt 76 votave që ka marrë kundërshtari i tij, ndërsa 13 vota janë shpallur të pavlefshme. Me marrjen e këtij posti Aliko tha se do të tërhiqej nga kandidatura për kryetar të Bashkisë Gjirokastrë në zgjedhjet vendore. "Ne do të mbështesim çdo kandidat tjetër që ju do jeni dakord për të marrë Bashkinë e Gjirokastrës", tha Aliko. Ndërkohë që edhe në Korçë është rizgjedhur një emër i njohur për demokratët. Bëhet fjalë për Andrea Manon, i cili mposhti në zgjedhje Elvin Bregun. Pjesëmarrja në votime ishte 70.6%, ndërsa Mano u konfirmua fitues me një shumicë dërrmuese, përkatësisht 90.9% të votave të delegatëve. Procesi zgjedhor në Bashkinë juglindore u ndoq nga afër nga sekretari i përgjithshëm Arben Ristani, i cili u kërkoi drejtuesve të rinj të bëhen gati edhe për variantin e zgjedhjeve të parakohshme. "Kështu si po shkon situata ndoshta do ketë zgjedhje të parakohshme bashkë me zgjedhjet lokale në të njëjtën kohë, pra në qershorin e vitit që vjen", tha Ristani. Ndërkohë që në Kurbin është konfirmuar kryetari aktual Behar Haxhiu, i cili ga-



Kreu i PD-së, Lulzim Basha me kryetarët e degëve

### LISTA E KRYETARËVE TË RINJ TË PD

- Gjirokastrë - Dashmir Aliko
- Korçë - Andrea Mano
- Gramsh - Kodhel Cala
- Kurbin - Behar Haxhiu
- Durrës - Ferdinand Xhaferaj
- Fier - Luan Baçi
- Dibër - Naim Gazidede
- Sarandë - Hariz Mema
- Kamzë - Xhelal Mziu
- Këlcyrë - Luan Malko
- Shijak - Rezart Tusha
- Malësi e Madhe - Anton Kokaj
- Librazhd - Bujar Vreto
- Malq - Donald Kulla
- Belsh - Bedri Qypja
- Devoll - Arben Miza

### ZGJEDHJET

Ndërkohë që mes emrave që janë rikonfirmuar këtë fundjavë bien në sy edhe ai deputetit të PD-së, Luan Baçi, i cili është rizgjedhur në krye të degës së PD-së në Fier. Ndërkohë që nuk sollën asnjë surprizë zgjedhjet në Kamzë, ku kryebashkiaku Xhelal Mziu mori një mandat të ri.

### Kreu i shtetit vizitoi Komunën e Rozhajës

## Meta në shkollën shqipe në Dacaj: Do jetoj me ëndrrat tuaja

Në mbyllje të vizitës së tij në Mal të Zi, kreu i shtetit, Nllir Meta zhvilloi një vizitë të veçantë në shkollën 9-vjeçare në gjuhën shqipe në fshatin Dacaj, të Komunës Rozhajë. Presidenti Meta u prit nga drejtori i shkollës, stafi pedagogjik, nxënësit dhe prindërit të tyre. Ndërsa i falënderoi ata për mikpritjen e treguar, theksoi se është i nevojshëm një bashkëpunim më i madh mes Shqipërisë dhe kësaj kraihine ku jetojnë shqiptarët. "Jam shumë i lumtur që kam ardhur në Rozhajë, akoma më i lumtur që jam në këtë shkollë për vetë historinë e saj, por edhe për vetë shpresat dhe aspiratat e këtyre fëmijëve që kemi këtu. Dua t'ju siguroj se nga kjo ditë do të jem gjithmonë në këtë shkollë! Do të jetoj me ëndrrat dhe me vështirësitë e realizimit të ëndrrave të këtyre fëmijëve këtu, dhe të gjithë fëmijëve shqiptarë të Rozhajës e kudo ndodhën", tha Meta. Pasi e përgëzoi stafin pedagogjik për punën e palodhur dhe të vështirë që bëjnë në këtë shkollë, veçanërisht për ruajtjen e gjuhës shqipe, Presidenti Meta i dhuroi shkollës 40 fotografi të përfaqësuesve më të spikatur të Rilindjes Kombëtare, një fotografi të Heroit tonë Kombëtar, Gjergj Kastriotit Skënderbeut si dhe një kolazh fotografish nga punimet e Kongresit të Manastirit, në kuadër të 110-vjetorit të Alfabetit të Gjuhës Shqipe. "Është kënaqësi t'ju uroj edhe Festën e 28 Nëntorit, Festën e Flamurit Kombëtar. Vite më parë do të ishte e pamajgjuvueshme që dikush nga Shqipëria të vinte këtu, por ja që kjo është tërësisht e mundur në sajë të marrëdhënieve të shkëlqyera që kanë Shqipëria dhe Mali i Zi. Edhe për shkak të kontributit të shkëlqyer që shqiptarët e Malit të Zi kanë dhënë për pavarësinë e tij, për integrimin në NATO dhe ecjen përpara të Malit të Zi drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian", tha Meta.

roi me Marjan Tucin. Edhe demokratët në Sarandë do të vijojnë të drejtohen nga kryetari aktual Hariz Mema, i cili fitoi me 177 vota përballë Shpëtim Iljazit, i cili mori 11 vota. Hariz Mema rikonfirmohet në detyrë, pasi është kryetar i PD për Sarandën prej vitit 2014. Ai është dhe anëtar i këshillit bashkiak të Sarandës dhe në vitin 2017 ka

qenë kandidat për deputet, konkretisht i 6 në listë në qarkun Vlorë. Zgjedhjet për kryetar të PD-së u zhvilluan dje edhe në Gramsh ku Kodhel Cala fitoi ndaj rivalit Elmas Haruni me 32 vota diferencë. I deleguar nga Partia Demokratike për qarkun e Elbasanit ishte deputeti Luçiano Boçi, i cili theksoi se procesi ishte demokratik dhe

kandidatët shpalosen platformat e tyre. Ndërkohë që mes emrave që janë rikonfirmuar këtë fundjavë bien në sy edhe ai deputetit të PD-së, Luan Baçi, i cili është rizgjedhur në krye të degës së PD-së në Fier. Ndërkohë që nuk sollën asnjë surprizë zgjedhjet në Kamzë, ku kryebashkiaku Xhelal Mziu mori një mandat të ri.

## PD: Vangjush Dako do të arrestohet, do apo nuk do Rama

Partia Demokratike ka vijuar edhe dje të akuzojë kryetarin e Bashkisë së Durrësit Vangjush Dako si të përfshirë në grupe kriminale dhe blerje votash. Deputetja e PD-së, Lindita Metaliaj në një dalje të posaçme për mediat tha se duke pasur prokurorinë politike si protektore të pushtetit iligjimit të Edi Ramës, kryetari i Bashkisë së Durrësit, mund ta shtyjë për pak arrestimin e tij, por ai e di shumë mirë se koha punon kundër tij. Sipas saj, përgjimet e "Dosjes 339" kanë zbuluar para të gjithëve se kryetari i Bashkisë së Durrësit, Vangjush Dako, është kapur në fa-



Deputetja e PD-së, Lindita Metaliaj

grancë duke bashkëpunuar me bandat në zgjedhje. "Strategjia e Edi Ramës për ta shitur bashkëpunimin me krimin si normalitet politik synon të mpijë reagimin e shoqërisë, por nuk ka për të funksionuar! Të vërteta e dosjes 339 për masakrën ele-

ktorale dhe pushtetin e blerë përmes bandave nuk mund t'i mbulojnë as kërcënimet e propaganda e Edi Ramës, as heshtja e Vangjush Dakos! Vangjush Dako do të arrestohet, do apo nuk do Edi Rama", tha Metaliaj.

### NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

#### ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
 B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m<sup>2</sup>, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
**ÇMIMI 49.754.880 LEKË** për secilën pasuri; në Total 99.509.760 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë 03.12.2018.  
 CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

### Njoftim për shitje me ankand të dytë

Sh "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 568, 577e vijues të K.P.C do të zhvillojë ankandin e dytë për pasuritë e palës debitorë B Kamberaj dhe L Kamberaj. Pasuria që shitet në ankand përbehet nga :  
 - "Truall + Godinë tre kateshe", me numer pasurie 14/283 në Z.K Nr.8602, volumni 35, faqe 144, truall 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqe e katit përdehe 117.9 m<sup>2</sup> në Lagjen 10 Korriku  
 Ankand i dytë i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën **6.272.000 LEKË**.  
 Ankandë qëndron i hapur 30 ditë dhe do të zhvillohet në datën 14.12.2018 në orën 15:00 në Bulevardin "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5, Tiranë. Ofertuesit duhet të tërhiqin dokumentacionin të kontaktojnë me shoqërinë si dhe mund të vizitojnë faqen WEB [www.powerjustice.al.com](http://www.powerjustice.al.com)

### Njoftim për shitje me ankand

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k bazuar në nenin 567, 568 të K.P.C. Civike ka shpallur shitjen me ankand të parë për pasurinë e palajshme të palës debitorë, hipotekeuse dhe palës dorëzante.  
 -"Toka Ate" nr Z K 1987 me numer pasurie 3038 Volumni 19 Faqe 71, me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> me çmim fillestar prej 72.520 Euro.  
 -"Toka Ate" nr Z K 1987 me numer pasurie 4056 Volumni 11 Faqe 92 , me sipërfaqe 1730 m<sup>2</sup> me çmim fillestar prej 125.460 Euro.  
 -"Toka Ate" nr Z K 1987 me numer pasurie 2573 Volumni 15 Faqe 239 , me sipërfaqe 2.000 m<sup>2</sup> me çmim fillestar prej 122.640 Euro.  
 Ankandë qëndron i hapur për 15 ditë dhe do të zhvillohet në datën 06.12.2018 prej orës 15:00, pranë selisë në Bulevardin "Gjergj Fishta" Pall. i shoqërisë "Gora" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr. 5 Ofertuesit mund të kontaktojnë me sh "Power & Justice"(P&J) sh.p.k dhe vizitojnë faqen WEB [www.powerjustice.al.com](http://www.powerjustice.al.com)

# PROJEKTLIGJI REFORMA

ASHK do të bëjë verifikimin në terren para përgatitjes së kartelave të pasurive

Të gjithë qytetarët që kanë një pronë të palu ajtshme duhet ta regjistrojnë atë nga fillimi. Kjo pasi projektligji i ri "Për Kadastrën" i paraqitur për shqyrtim dhe miratim në Kuvend përfaqëson një domosdoshmëri për t'i dhënë fund problemeve me pronat e paluajtshme në Shqipëri, por edhe për të krijuar një regjim kadastral të rregullt dhe të pakontestueshëm, regjistrimin fillestar të tyre. Më konkretisht bëhet fjalë për procesin e reflektimit të pasurive për herë të parë në regjistër, pasqyrimi në kartelë dhe hartën kadastrale. Ky proces do të kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe do të realizohet për çdo zonë kadastrale. Natyrisht që pas verifikimeve që do të bëjnë specialistët e ASHK-së në terren për kufijtë e pronave, një rol decisiv në këtë proces do të kenë edhe vet qytetarët, të cilët duhet të paraqesin çdo dokument që vërteton pronësinë dhe kufijtë e pronës.

## FILLIMI I REGJISTRIMIT

Regjistrimi fillestar bëhet për një zonë kadastrale të identifikuar nga drejtoria vendore dhe ai konsiston në pasqyrimin e çdo pasurie të paluajtshme shtetërore, publike dhe private, të zonës kadastrale, në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale të zonës. Drejtuesi i drejtorisë vendore, një person ose çdo grup i ngarkuar nga drejtori i Përgjithshëm do të kërkojë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të akteve të fitimit të pronësisë. Ndërkohë që individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, por që nuk kanë të përcaktuar në tok sipërfaqen, duhet t'i paraqesin regjistruarit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me dokumentin e pronësisë dhe deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet. Nëse deklaratat noteriale nuk mund të sigurohet apo kur ka mosmarrëveshje për kufirin e pasurive, ai përcaktohet nga ASHK-ja. Palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit të ASHK-së. Drejtoria vendore, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuarës. Kundër vendimit të drejtorisë vendore ose në mungesë të përgjigjes brenda afatit, kërkuarës gjykata thërrret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë kufitare me njëra-tjetrën e të cilët kanë interes të ligjshëm për gjykim.

5. Për pasqyrimin e saktë hartografik të pasurive, ASHK-ja shfrytëzon produktin e fotografimit ajror të Republikës së Shqipërisë.

6. Për çdo pasuri të identifikuar nga verifikimi në terren dhe që gjendet në hartën e re kadastrale, krijohet praktika e pronësisë me dokumentacionin që parashikohet në këtë ligj.

7. Procedura e regjistrimit fillestar fillon me vendim të drejtuesit të zyrës vendore ose me vendim të drejtorit të Përgjithshëm.

8. Procedura paraprake e regjistrimit fillestar zgjat jo më shumë se 45 ditë.

# Nisma në Kuvend, ja si do bëhet regjistrimi fillestar i pronës

Harta kadastrale do publikohet për konsultim publik



Gjatë një mbledhjeje qeverie

## PUBLIKIMI

Pas hartimit të hartës paraprake kadastrale si dhe përgatitjes së kartelave të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë të administruar nga drejtoria vendore shpallet publikisht zona që është objekt regjistrimi.




Foto ilustruese

## Dokumentet që duhen për regjistrimin e një prone

Procesi i Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme kalon në disa faza duke filluar nga mbledhja dhe saktësimi i dokumentacionit; përgatitja e hartës dhe kartelës së pasurive të paluajtshme; afishimi publik 45-ditor (saktësimi dhe verifikimi) si edhe; marrja e certifikatës së pronësisë në bazë të kërkesës së pronarit pranë zyrës vendore të ASHK-së. Shqipëria ka më shumë se 4.5 milionë prona të ndara në 12 qarqe dhe rreth 3000 zona kadastrale. Çdo pronë ka një kartelë që tregon emrin e pronarit, tipin e pronësisë, vendndodhjen fizike dhe madhësinë e pronës. Ajo tregon, gjithashtu, çdo ngarkesë ose kufizim në transferimin e pronës si p. sh të drejtën e përdorimit të tokës nga të tjerët, hipotekimin, dhënie me qira ose problemet gjyqësore. Çdo pronë, pavarësisht nëse është një parcelë apo ndërtesë, ka një numër unik identifikimi, i cili referohet në kartelë dhe në Hartën Treguese të Regjistrimit (HTR). Baza e këtij sistemi krijohet nëpërmjet procedurës së Regjistrimit Fillestar të Pasurive të Paluajtshme. Deri më tani ka patur disa projekte pilot për regjistrimin fillestar dhe me këtë projektligj synohet që ky proces të përmirësohet dhe të shtrihet në gjithë vendin.

## PROJEKTLIGJI "PËR KADASTRËN"

### Neni 30

#### Fillimi i regjistrimit fillestar

1. Regjistrimi fillestar bëhet për një zonë kadastrale të identifikuar nga drejtoria vendore.
2. Regjistrimi fillestar konsiston në pasqyrimin e çdo pasurie të paluajtshme shtetërore, publike dhe private, të zonës kadastrale, në kartelën përkatëse të pasurisë dhe në hartën kadastrale të zonës.
3. Drejtuesi i drejtorisë vendore, një person ose çdo grup i ngarkuar nga drejtori i Përgjithshëm kërkojnë që pronësia, si dhe kufijtë e çdo pasurie që duhet regjistruar, të dokumentohen në bazë të akteve të fitimit të pronësisë, sipas nenit 193 të Kodit Civil.
4. Individët, familjet dhe personat juridikë, privatë apo shtetërorë, që zotërojnë dokumente pronësie, sipas shkronjës "a" të kësaj pike, por nuk kanë të përcaktuar në tok sipërfaqen, duhet t'i paraqesin regjistruarit një kërkesë për regjistrim pronësie, e cila duhet të shoqërohet me:

- a) dokumentin e pronësisë;
  - b) deklaratën noteriale të pronarëve kufitarë, që vërtetojnë përmbajtjen e kërkesës për kufijtë e pasurisë që pretendohet të regjistrohet.
- Nëse deklaratat noteriale nuk mund të sigurohet apo kur ka mosmarrëveshje për kufirin e pasurive, ai përcaktohet nga ASHK-ja. Palët e interesuara kanë të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj aktit të ASHK-së.

Drejtoria vendore, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës, duhet t'i kthejë përgjigje kërkuarës. Kundër vendimit të drejtorisë vendore ose në mungesë të përgjigjes brenda afatit, kërkuarës gjykata thërrret të gjithë pronarët, pronat e të cilëve janë kufitare me njëra-tjetrën e të cilët kanë interes të ligjshëm për gjykim.

5. Për pasqyrimin e saktë hartografik të pasurive, ASHK-ja shfrytëzon produktin e fotografimit ajror të Republikës së Shqipërisë.
6. Për çdo pasuri të identifikuar nga verifikimi në terren dhe që gjendet në hartën e re kadastrale, krijohet praktika e pronësisë me dokumentacionin që parashikohet në këtë ligj.
7. Procedura e regjistrimit fillestar fillon me vendim të drejtuesit të zyrës vendore ose me vendim të drejtorit të Përgjithshëm.
8. Procedura paraprake e regjistrimit fillestar zgjat jo më shumë se 45 ditë.

### Neni 31

#### Konsultimi publik

1. Pas hartimit të hartës paraprake kadastrale si dhe përgatitjes së kartelave të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë të administruar nga drejtoria vendore shpallet publikisht zona që është objekt regjistrimi.
2. Njoftimi publik bëhet në vende të dukshme për të interesuarit esaj zone kadastrale.
3. Njoftimi duhet të përmbajë kopjen e hartës dhe emrat e pronarëve të pronave që janë identifikuar deri në atë çast nga drejtoria vendore. Njoftimi duhet të caktojë mënyrën dhe vendin ku do të paraqiten pretendimet e të interesuarve.
4. Njoftimi mbetet i afishuar për 45 ditë. Brenda kësaj periudhe lejohet të paraqiten ankesa dhe pretendime nga të interesuarit.
5. Pas kalimit të afatit 45-ditor, drejtoria vendore nuk pranon më ankesa.

### Neni 32

#### Përfundimi i regjistrimit fillestar

1. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit publik dhe të trajtimit të ankesave, drejtoria vendore ligjëson regjistrimin e bërë:
  - a) duke formalizuar kartelën e pasurisë të çdo prone dhe duke arkivuar dokumentacionin përkatës sipas nenit 13, të këtij ligji;
  - b) duke formalizuar hartën kadastrale zyrtare sipas nenit 15, të këtij ligji;
  - c) duke lëshuar certifikatën e pronësisë për çdo pronar të interesuar të zonës së regjistruar, që ka shlyer tarifat përkatëse të regjistrimit.
2. Drejtoria vendore mund të bëjë vetëm korrigjime të gabimeve në procesin e regjistrimit, por jo të trajtojë ankesa për shtesa të reja. Ankesat paraqiten pranë strukturës së posaçme për ankimet.

### Neni 34

#### Regjistrimi fillestar i pasurisë publike

1. Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, që kanë në administrim toka, ndërtesa, pasuri natyrore, pyje, kullota, lumenj, liqene, vepra infrastrukturore si dhe çdo pasuri tjetër që nuk është private, detyrohen të regjistrojnë këto prona në zyrën kadastrale të vendit ku ndodhen këto objekte.
2. Gjatë regjistrimit fillestar të zonës kadastrale, për pasuritë shtetërore apo të transferuara te njësitë e vetëqeverisjes vendore zbatohen procedurat e parashikuara në legjislacionin për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.

tografik të pasurive, ASHK-ja shfrytëzon produktin e fotografimit ajror të Republikës së Shqipërisë. Për çdo pasuri të identifikuar nga verifikimi në terren dhe që gjendet në hartën e re kadastrale, krijohet praktika e pronësisë me dokumentacionin përkatës. Procedura paraprake e regjistrimit fille-

star zgjat jo më shumë se 45 ditë.

## KONSULTIMI PUBLIK

Pas hartimit të hartës paraprake kadastrale si dhe përgatitjes së kartelave të pasurive të paluajtshme, në bazë të dokumentacionit të pronësisë të administruar nga drejtoria vendore shpallet publikisht zona që është

objekt regjistrimi. Njoftimi publik bëhet në vende të dukshme për të interesuarit esaj zone kadastrale. Njoftimi duhet të përmbajë kopjen e hartës dhe emrat e pronarëve të pronave që janë identifikuar deri në atë çast nga drejtoria vendore. Njoftimi mbetet i afishuar për 45 ditë dhe brenda kësaj periudhe

lejohet të paraqiten ankesa dhe pretendime nga të interesuarit. Pas përfundimit të periudhës së konsultimit publik dhe të trajtimit të ankesave, drejtoria vendore ligjëson regjistrimin e bërë duke formalizuar kartelën e pasurisë, hartën kadastrale dhe duke lëshuar certifikatën e pronësisë të çdo prone.





Krijimi i ASHK-së do sjellë dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësit aktual

# Shkrihen Hipotekat dhe ALUIZNI, punonjësit e tyre edhe 6 muaj punë

*Mban vendin e punës kush nuk preket nga ristrukturimi*

**K**rijimi i Agjencisë Shtetërore të Kadasrës, si një institucion i ri që do të kryejë funksionet e deritanishme të ZRPP-së (hipoteka), ALUIZNI-t dhe AIPPP, përveçse do të sjellë unifikim dhe procedurë krejt të reja lidhur me trajtimin dhe regjistrimin pasurive e paluajtshme, do të sjellë dhe një ristrukturim të gjithë administratës që funksionon deri më sot në këto institucione të rëndësishme. Për rrjedhojë, si pasojë e këtij bashkimi rrezikojnë vendin e punës të gjithë punonjësit që aktualisht punojnë në këto institucione. Projektligji i ri që është paraqitur në Kuvend "Për Kadastrën" përcakton në dispozitat kalimtare të tij se me hyrjen e tij në fuqi "të gjithë punonjësit e Zyrës së Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme, Agjencisë së Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Objekteve/Ndërtimeve Informale, Konsiderohen punonjës të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës". Por kjo gjithmonë sipas këtij projektligji jo më gjatë se "për një periudhë kalimtare 6-mujore nga hyrja në fuqi e këtij ligji". Ata do mund të jenë sërish pjesë e administratës së këtij institucioni të ri që do të krijohet, por vetëm "nëse nuk preken nga ristrukturimi dhe plotësojnë kriteret e kualifikimit sipas rregullores të miratuara nga këshilli drejtues i ASHK-së". Pra, siç përcaktohet në këtë dispozitë, që punonjësit aktual të vijnë në qendrorë në vendet e tyre të punës edhe pas 6 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do duhet që ata të mos preken nga ristrukturimi. Por për një institucion të ri që do krijohet nga e para, pavarësisht se në përberje do ketë të tre institucionet ekzistuese, është shumë e vështirë që ai të mbajë strukturat, pra të njëjtin mënyrë organizimi siç e kanë aktualisht këto institucione. Ndaj me krijimin e ASHK-së pritet të ndryshojë edhe e gjithë struktura aktuale e këtyre institucioneve, ndaj dhe rreziku për të humbur vendin e punës është i pranishëm për thuajse shumicën dërmuese të punonjësve të këtyre tre institucioneve. Ndërkohë që Neni 11 i këtij projektligji tekta flet për marrëdhëniet



**DEFICITI**  
Në analizën financiare që shoqëron këtë projektligj, hartuesit kanë evidentuar se të tria institucionet së bashku i sjellin shtetit çdo vit një borxh prej 600 milionë lekë të reja, kjo nisur nga të ardhurat që sigurojnë dhe shpenzimet e mëdha që kryejnë, pjesa dërmuese paga dhe shpërblime.

## SHKURTE

### ASHK, institucion me vetëfinancim në varësi direkte të kryeministrit

Agjencia Shtetërore e Kadastrës do jetë në varësi direkte të kryeministrit dhe funksionon si institucion me vetëfinancim. Burimet e financimit të këtij institucioni do të jenë: të ardhurat e krijuara nga vetë Agjencia, të ardhurat nga Buxheti i Shtetit dhe donacionet e ndryshme. Por pavarësisht se në projektligj parashikohet mbështetje financiare edhe nga Buxheti i Shtetit, hartuesit e kësaj nisme kanë parashikuar që ASHK-ja të ketë mbështetje buxhetore shtetërore vetëm për 2019. Agjencia Shtetërore e Kadastrës organizohet në nivel qendror nëpërmjet Drejtorisë e Përgjithshme në Tiranë dhe në nivel vendor në drejtori e zyra, si struktura varësie. Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë këshilli drejtues dhe drejtori i Përgjithshëm, i cili është njëkohësisht edhe anëtar i këshillit drejtues. Drejtori i Përgjithshëm i ASHK-së emërohet dhe shkarkohet direkt nga kryeministri. Ndërkohë që sa i përket fazës tranzitore drejtuesit e institucioneve aktuale që ristrukturohen në funksion të zbatimit të këtij ligji, me urdhër të përbashkët, krijojnë komisione për realizimin e procesit të ristrukturimit sipas kushteve të këtij ligji. Ky proces udhëhiqet nga Bordi Drejtues i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nën mbikëqyrjen e ministrit të Drejtësisë dhe Zyrës së Kryeministrit.

### Ja si bëhet korrigjimi i titullit të pronësisë për ndërtesat

Të gjithë ata që zotërojnë një pasuri të paluajtshme të llojit ndërtesë dhe që kanë mospërputhje të gjendjes faktike me atë që pasqyrohet në kartelë, projektligji në fjalë përcakton një zgjidhje të re. Ndryshe nga tani ku si pasojë e kësaj parregullsie ZRPP-ja të zvarriste pafundësisht në regjistrimin e pronës, tashmë me projektligjin e ri, parashikohet një procedurë krejt e re dhe që synon ta mbyllë si proces në një kohë shumë të shkurtër. Kështu për pasuritë e llojit ndërtesë, problemet e mospërputhjes së pozicionit, konfigurimit, përmasave dhe sasisë së sipërfaqes zgjidhen duke korrigjuar hartën kadastrale dhe regjistrin apo vetë titullin e pronësisë, sipas gjendjes faktike të ndërtesës. Pra, specialistët e ASHK-së për çdo rast të tillë duhet të bëjnë verifikimin e gjendjes faktike në teren dhe nëse ajo nuk ka probleme mbivendosje me pronarë të tjerë, duhet të bëjnë regjistrimin e pronës. Përjashtimisht, kur sipërfaqja në terren është më e madhe se ajo e përcaktuar në titull, drejtorja vendore verifikon nëse në ndërtesë janë kryer zhvillime ndërtimore pa leje dhe i trajton ato sipas legjislacionit përkatës.

## NENI 9

### ■ Drejtori i Përgjithshëm

- Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri.
- Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë ligj dhe në ligje të tjera të posaçme, kryen këto detyra:
  - Drejton aktivitetin e Agjencisë në fushat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe të përfundimit të proceseve kalimtare të pronësisë, sipas objektivave politike të Këshillit të Ministrave, planeve strategjike dhe programeve të performancës.
  - Harton projektprogramin buxhetor afatmesëm dhe projektprogramin vjetor të veprimtarisë të vitit të ardhshëm financiar.
  - Harton programe dhe miraton urdhra e udhëzime për funksionimin, zhvillimin, përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve kadastrale dhe të aktivitetit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë.
  - Emëron dhe liron personelin e Agjencisë përfshirë dhe drejtuesit e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor.
  - Propozon këshillit drejtues ndërmarrjen e nismës për rishikimin apo ndryshimin e tarifave të shërbimeve të ofruara nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, me qëllim mbulimin e kostove të shërbimit dhe menaxhimin me efikasitet të të ardhurave.
  - Ushtron kontroll mbi veprimtarinë e drejtorive dhe zyrave në nivel vendor, duke përfshirë edhe auditimin sipas legjislacionit përkatës.
  - Përcakton kriteret e veçanta që duhet të plotësohen nga personeli i Agjencisë, rregullat për testimin e aftësive profesionale, si dhe planet për trajnimin e burimeve njerëzore.
  - Propozon këshillit drejtues strukturën, organikën, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të Agjencisë.
- Drejtori i Përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga zëvendës-drejtorët e përgjithshëm, një prej të cilëve është drejtues i strukturës përgjegjëse për ankimin administrativ. Zëvendës-drejtorët e përgjithshëm emërohen nga këshilli drejtues, me propozim të drejtorit të Përgjithshëm.

e punës përcakton se për punonjësit e ASHK-së këto marrëdhënie rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës, ndërsa niveli i pagave të punonjësve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Për të qenë pjesë sërish e këtij institucioni të ri, punonjësit duhet të përmbushin kriteret e përgjithshme sipas legjislacionit për shërbimin civil, si dhe kri-

teret e veçanta të përcaktuara nga drejtori i Përgjithshëm. Punonjësit përzgjidhen, sipas kërkesave të pozicionit specifik të vendit të punës dhe ata për t'u punësuar pranë ASHK-së i nënshtrohen procedurës së testimit paraprak. Në analizën financiare që shoqëron këtë projektligj, hartuesit kanë evidentuar se të tria institucionet së bashku i

sjellin shtetit çdo vit një borxh prej 600 milionë lekë të reja, kjo nisur nga të ardhurat që sigurojnë dhe shpenzimet e mëdha që kryejnë, pjesa dërmuese paga dhe shpërblime. Ndaj me këtë ristrukturim të ri që do të sjellë ASHK, synohet që reduktohet numri i punonjësve dhe për rrjedhojë të ulen edhe shpenzimet e paga e shpërblime.

shpenzimet e mëdha që kryejnë, pjesa dërmuese paga dhe shpërblime. Ndaj me këtë ristrukturim të ri që do të sjellë ASHK, synohet që reduktohet numri i punonjësve dhe për rrjedhojë të ulen edhe shpenzimet e paga e shpërblime.

Akordi pas disa takimeve të zhvilluara në Tiranë

# Gjermania jep 164.4 milionë euro për përmirësimin e jetës

## Schütz: Shifra rekord është provë e mbështetjes për BE

Gjermania kthehet në donatorin më të madh të Shqipërisë. Fokusi i fondit të ri, 164.4 milionë euro do të jetë ekonomia, përmirësimi i jetës së njerëzve, ndihmesa për integrimin në BE e projekte rajonale, shkruan sot Deutsche Welle.

Një fond prej 164.4 milionë eurosh, që Qeveria Federale do t'i lëvrojë Shqipërisë për periudhën 2019 -2021, është publikuar në përfundim të bisedimeve qeveritare mes dy vendeve për politikën në zhvillim të enjten (22.11). Bisedimet u zhvilluan në Tiranë, të kryesuarua për palën shqiptare nga Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, dhe palën gjermane nga Drejtori i Drejtorisë për Evropën Juglindore në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Dirk Schattenschneider.

Në një njoftim për shtyp nga ambasada gjermane në Tiranë, bëhet e ditur që krahas fondit të përmendur më lart, Banka Gjermane për Rindërtim, KfW, do të lëvrojë, për Ministrinë e Financave në Shqipëri, një kredi prej 100 milionë eurosh. Prej korrikut 2016 Gjermania ka vënë në dispozicion të projekteve të përbashkëta me Shqipërinë 102.5 milionë euro, duke u shndërruar në donatorin e saj më të madh bilateral.

"Shifrat rekord janë provë e rëndësishme të madhe që Qeveria Federale i kushton mbështetjes së Shqipërisë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian. Në 30 vitet e fundit ne kemi qëndruar vazhdimisht në krah të Shqipërisë dhe do të vazhdojmë të mbetemi një part-



Fotoilustruese

ner i besueshëm i saj", tha pas përfundimit të bisedimeve qeveritare, ambasadorja gjermane në Tiranë, Susanne Schütz.

Fondet gjermane në fokus përmirësimi i jetës së njerëzve, integrimi në BE

Gjermania do të lëvrojë fondin prej 164.4 milionë eurosh për projekte të përbashkëta gjermano-shqiptare në sektorët e energjisë, ujësjellës-kanalizimeve, menaxhimit të mbetjeve dhe zhvillimit ekonomik. Por edhe për zgjerimin e bashkëpunimit me vendet fqinje në kuadër projektesh rajonale, që lidhen me procesin e integritimit evropian, luftën kundër krimeve të rënda, pastrimin e detit dhe mbrojtjen nga përmytjet.

Drejtori i Drejtorisë për Evropën Juglindore në Ministrinë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, Dirk Schattenschneider, është shprehur, se "për ne është e rëndësishme që, nga njëra anë të përmirësojmë në mënyrë konkrete kushtet e jetesës së njerëzve me projekte në furnizimin me energji dhe ujë, dhe nga ana tjetër të zhvillojmë institucionet shqiptare duke i bërë të afta për në BE. Gjithashtu, Gjermania kontribuon që Shqipëria të përballon me sfidat së bashku me fqinjët e saj, që brezat e ardhshëm në rajonin e Ballkanit Perëndimor të trashëgojnë perspektivën për një jetesë të mirë dhe në paqe."

Schütz - Në pritje të vendimit të BE për negociatat Mbështetja e Gjermanisë

ndaj Shqipërisë në rrugën e zhvillimit ekonomik është më tepër se fondet financiare. Ambasadorja gjermane Susanne Schütz vuri në dukje se "Gjermania vë në dispozicion jo vetëm fonde financiare të shumta dhe ekspertizë profesionale, por ne jemi, gjithashtu, edhe një konsulent kritik. Ne, inkurajojmë Shqipërinë të vijojë në mënyrë konsekuente rrugën e nisur të reformave, veçanërisht atë në sektorin e drejtësisë dhe luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në pritje të vendimmarrjes së BE-së pranverën e vitit të ardhshëm lidhur me çeljen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë, duhet thënë se nuk ka kohë për të humbur".

Gjermania - donatori më

i madh bilateral i Shqipërisë

Ky vit është viti i 30-vjetorit të marrëdhënieve ekonomike për zhvillim Gjermani-Shqipëri. Gjermania ishte vendi i parë, që lidhi marrëdhënie të bashkëpunimit për zhvillim me Shqipërinë në vitin 1988. Që atëherë dhe deri më sot Gjermania ka vënë në dispozicion të zhvillimit ekonomik të Shqipërisë rreth 1 miliard euro, duke u bërë vendi donator më i madh bilateral i Shqipërisë. Pjesa më e madhe e projekteve zbatohen përmes GIZ-së dhe KfW, por edhe përmes organizatave qeveritare dhe fondacioneve politike gjermane Konrad Adenauer, Friedrich Ebert dhe Hanns Seidel. Bashkëpunimi për Zhvillim është fokusuar kryesisht në energji, ujë, ujësjellës, mbetje, arsimit profesional, mbështetje e sipërmarrjeve të reja, nxitje e zhvillimit rural e përshtatje e legjislacionit ekonomik me Acquis.

/DW/

**osce** Organization for Security and Co-operation in Europe  
Presence in Albania

## Request for Proposal RFP/01/ALB/2018

### THE PROVISION OF CONFERENCE SERVICES AND HOTEL ACCOMMODATION IN TIRANA, DURRES, VLORE, SARANDA, ELBASAN, POGRADEC, KORCE, SHKODER AND KUKES

The OSCE Presence in Albania invites Proposals from eligible and qualified companies for the provision of conference services and hotel accommodation in the cities of Tirana, Durres, Vlore, Saranda, Elbasan, Pogradec, Korce, Shkoder and Kukës.

It is expected that the aggregate duration of the proposed contract will be three (3) years.

Deadline for receipt of proposals is **19 January 2019, 14:00 hrs CET**.

Potential bidders interested to receive a complete set of the Bidding Documents are kindly requested to contact the OSCE at the following email address: [procurement-al@osce.org](mailto:procurement-al@osce.org)

**NOVARTIS**

Novartis Pharma Services Inc. Tirana-Albania, the Representative Office of the multi-national company, NOVARTIS, the worldwide leader in the pharmaceutical industry, wants to hire a **Marketing Assistant**.

#### JOB PURPOSE:

Offers support for the marketing activities organised by the Representative Office in Tirana-Albania.

#### Some of his/her qualifications and requirements would be:

- University degree in Marketing, Business & Administration or other areas with similar knowledge
- Extra Knowledge of medical background preferable
- Very High Proficiency in English and local language (oral and written)
- Digital literacy with technology skills (Microsoft Office package)
- Outstanding organizational and coordination skills
- Excellent communications, interpersonal and negotiation skills
- Must demonstrate ability to prioritize and handle multiple tasks in a timely fashion, with minimum supervision and efficient follow-up
- Implement with excellence the planned activities and marketing campaigns adhering to the relevant Codes of Practice/regulations.

The interested candidates are invited to send the CV-s at the e-mail address: [blerta.rambi@novartis.com](mailto:blerta.rambi@novartis.com). Deadline 30 November 2018

Only the selected candidates will be contacted.



**F**orca e Ligjit në Terri tor godet një rast të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike në Sarandë. Sekuestrohen rreth 32 kilogramë lëndë narkotike cannabis sattiva. Në pranga 3 persona përgjegjës. Në kuadër të operacionit Forca e Ligjit në Territor, strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë konkretisht shërbimet e Komisarariatit të Policisë Sarandë në



## Sarandë, kapen 3 të rinj me 32 kilogramë marijuanë

vijim të punës hetimore për parandalimin e veprimtarive të ndryshme kriminale, pas kontrolleve të befasishme në lagjen nr.4 Sarandë, konstatuan se në automjetin tip "BMV X5", drejtuar nga shtetasi E. K., (bagazh) u gjet një sasi me lëndë narkotike e dyshuar e llojit cannabis sattiva me peshë totale prej 32 kilogramë.

Narkotikët e Sarandës kanë bërë arrestimin e 3 shtetasve, të cilët dyshohen se janë persona të implikuar dhe autorë përgjegjës në lidhje me ngjarjen: S. Ç., 27 vjeç, lindur në Elbasan dhe banues në Tepelenë; A. P., 25 vjeç, lindur dhe banues në Tepelenë (i dënuar më parë për vjedhje); E. K., 31 vjeç, lindur dhe banues në Tepe-

lenë (drejtuesi i mjetit BMV X5). U bllokuan dhe u sekuestruan në cilësinë e provave materiale: një automjet tip BMW, një automjet tip Mercedes Benz, 5 aparatë telefonikë celularë. Materialet iu referuan prokurorisë për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike, kryer në bashkëpunim".

Tre të tjerë ende në kërkim për përfshirje në vrasjen e Gaxhës

**V**etëdorëzohet në policinë e Tiranës Ajaks Boshnjaku, një nga të shpallurit në kërkim për ngjarjen në ish-Bllok ku mbeti i vrarë një person dhe u plagosën dy të tjerë. Ngjarja ndodhi në 4 tetor të këtij viti dhe u tha se gjithçka ndodhi pas një ngacmimi që i kishin bërë këngëtares Elvana Gjata. Ajaks Boshnjaku është vetëdorëzuar mbrëmjen e djeshme në Drejtorinë e Policisë së Tiranës i shoqëruar nga avokati i tij ndërsa ende mbeten në kërkim Ervin Mata i fejuari i këngëtares, dhe miqtë e tij, Fabio Allushi dhe komando Meviol Bilo. Ky i fundit dyshohet të jetë autor i vrasjes së Fabian Gaxhës. Nga hetimet rezultoi se Boshnjaku ka qenë i pranishëm në lokal në momentin kur komandoja Meviol Bilo i kundërpërgjigj sulmit me armë nga Fabian Gaxha, duke lënë të vrarë këtë të fundit dhe duke plagosur Ervis Martinajn e Elio (Emerald) Hato. Në lidhje me ngjarjen janë arrestuar Ervis Martinaj dhe Elio Hato, ndërsa janë shpallur në kërkim nga policia Ervin Mata, Fabio Allushi dhe Meviol Bilo. Pak ditë më parë Gjykata e Krimeve të Rënda ka shtyrë me 30 ditë burg masën e arrestit për Ervis Martinajn, i cili u përfshi në përplasjen me armë zjarri në zonën e Bllokut. Gjykatësi Artan Gjermeni ka

# Vrasja në Bllok, dorëzohet në polici Ajaks Boshnjaku

*Miku i Ervin Matës ishte prezent në ngjarje*



lexuar akuzat për Martinajn, pastrim e produkteve të veprës penale, falsifikim dokumentesh, fshehje e pasurisë, dhe organizim i lojërave të paligjshme. Janë këto akuzat të ngritura nga prokuroria për Martinajn dhe pritet që 30 ditët e tjera të sigurohen prova të reja për të kërkuar masën arrest me burg. Gjykatësi rilexoi në vendimin e tij përgjimet nga telefoni i Martinaj, ku bisedon me miqtë e tij, bisedat para përplasjes me armë. Pas ekspertimit kimik të bërë, gjykata konstatoi se e kishte gabim. Nuk u konstatua mjetje të nitrive në duart e Martinajt. Sipas aktit të ekspertimit të celularit, karta SIM nuk korrespondon me telefonatat që i janë bërë Martinajt.

### SHKURT

**Kapen me 200 gram kokainë dhe 8 mijë euro shqiptari në Itali**

Një shqiptar, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije është arrestuar nga policia italiane pasi gjatë kontrolleve i është gjetur një sasi kokaine si dhe 8 mijë euro cash. Siç raportojnë mediat lokale, shqiptari shiste kokainë me një makinë të tipit "Fiat" në rrugët e Stezanos. Ndalimi i shqiptarit u bë nga autoritetet në sajë të operacioneve, të cilat kishin për qëllim goditjen e personave të rrezikshëm për sigurinë publike dhe trafikantëve të drogës, raporton "BalkanWeb". 40-vjeçari shqiptar në momentin e arrestimit kishte një sasi kokaine prej 40 gram, kjo e ndarë në 19 doza të vogla si dhe shumën e eurove. Pas arrestimit të shqiptarit, autoritetet e shtrinë kontrollin edhe në banesën ku jetonte 40-vjeçari tekta gjetën edhe 150 gram të tjera kokainë, e cila ishte fshehur në një vazo keramike në dhomën e ndenjes. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan edhe disa pajisje, të cilat shqiptari i përdorte për ndarjen e lëndës narkotike në doza të vogla.

## Në aksin "Theologos - Malesina" kafshë të egra presin rrugën

**Përplasjet në Greqi, vdes 38-vjeçari, Banorët: Shkak mund të jenë derrat**



rrugës për në spital. Menjëherë është ngritur një grup hetimor dhe po punon për zbardhjen e sh-

### AKSIDENTI

Shqiptari tekta drejtohe makinën për një moment ka humbur kontrollin duke përfunduar më pas në oborrin e një shtëpie ndërsa është përplasur edhe me pemët. Ambulanca dhe shërbimi mjekësor kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, por nga plagët e marra 38-vjeçari ka humbur jetën rrugës për në spital.

kaqeve të vërteta të ngjarjes. Në të njëjtën kohë edhe banorët e zonës kanë folur për mediat greke, të cilët theksojnë se shqiptari jetonte me familjen prej kohësh në Greqi dhe ishte një njeri i qetë dhe aspak problematik. "Ai ishte një shofer shumë i mirë. Dicka ka ndodhur. Ndoshta ai ishte duke manovruar për të shmangur derrat e egër. Në rrugë atë natë kanë lëvizur derrat", thotë një banor i rajonit. Siç pretendojnë banorët, shkak për ngjarjen mund të jenë bërë derrat, të cilët dalin papritur nëpër segmentin e kësaj rruge, ku gjeti vdekjen edhe shqiptari.

### Vdes në burgun grek 35-vjeçari shqiptar

Gjendet i vdekur një i burgosur shqiptar 35 vjeç në burgun e Trikalas Greqi. Policët e gjetën të vdekur në krevat, kur hynë në qeli, sepse nuk përgjigjeje drejtohe. Mediat greke shkruajnë se Policia po heton shkaqet e ngjarjes. Ky nuk është shqiptari i parë që gjen vdekjen në burgjet greke. Ilija Kareli humbi jetën i dhunuar dhe i torturuar nga policia në burg. Ngjarja shkaktoi tronditjen e opinionit publik shqiptar pas zbulimit të episodeve të dhunës. Por për rastin e fundit nuk dihet ende se cilat kanë qenë shkaqet e vdekjes.

Një shqiptar 38-vjeçar është përplasur për vdekje të shtunë në Greqi tekta po lëvizte në rrugën "Theologos - Malesina". Ngjarja bëhet me dije nga mediat greke, por nuk jepen detaje mbi gjendjetet e tij. Raportohet se shqiptari tekta drejtohe makinën për një moment ka humbur kontrollin duke përfunduar më pas në oborrin e një shtëpie ndërsa është përplasur edhe me pemët. Ambulanca dhe shërbimi mjekësor kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, por nga plagët e marra 38-vjeçari ka humbur jetën

Ministrja e Mbrojtjes Sociale: Garantohej urdhri i menjëhershëm i mbrojtjes

Voltiza Duro

Vetëm gjatë 10 muajve të këtij viti, janë denoncuar 4182 raste dhune, nga të cilat janë bërë mbi 2500 kërkesë-padi. Sipas statistikave, një në 3 gra në Shqipëri raporton të jetë përbullur të paktën 1 herë me dhunën. Presidenca i është bashkuar fushatës botërore "Ta ngjyrosim botën portokalli", kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Në ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj grave, kreu i shtetit Ilir Meta jep një mesazh dhe qëndrim të qartë. Dhuna ndaj grave është dobësi dhe jo burrëri. "Është një plagë e shenjë turpi për shoqërinë, një pengesë e madhe për zhvillimin gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Dhuna ndaj grave është dobësi dhe jo burrëri. Është një plagë e shenjë turpi për shoqërinë, një pengesë e madhe për zhvillimin gjithëpërfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm, shkruan presidenti në një status në "Facebook". Meta deklaroi in prerë se nuk do të amnistojë asnjë të dënuar për vepra penale të dhunës në familje. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale çeli dje fushatën e 16 ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore. "Sot një grua që denoncon

# Presidenti Ilir Meta: Nuk do të ketë amnisti për dhunuesit në familje

## Denoncohen 4182 raste dhune, mbi 2500 kërkesë-padi



dhunën është shumë më e mbrojtur, sepse me ndryshimet ligjore që miratua në Kuvend, garantojnë urdhri e menjëhershëm të mbrojtjes për gratë viktime të dhunës në 24 orët e para

të denoncimit", tha ministria Manastirliu. Duke vënë theksin te rëndësia e parandalimit të dhunës, Manastirliu tha se duhet të bëhemi të gjithë bashkë për mbështetjen e vajzave dhe grave, në



luftë me stigmën dhe mohimin ndaj fenomenit. "Gratë nuk lindin gra, ato lindin vajza ndaj që në vogëli duhet të punojmë për edukimin e tyre, sepse arsimimi, por edhe fuqizimi ekonomik i

gruas janë elemente thelbësore për të reduktuar këtë fenomen, që për fat të keq, është ende i përhapur në shoqërinë tonë", tha Manastirliu. Në ditën ndërkombëtare kundër dhunës, Manastirliu

theksoi se duhet shpejtuar ngritja e mekanizmit të referimit të dhunës në familje në çdo bashki, si përgjigje e menjëhershme ndaj rasteve të dhunës në çdo komunitet, sa më afër viktimave të dhunës. Duke theksuar rëndësinë e përfshirjes edhe të burrave në betejën me dhunën, ministria bëri një apel për gratë dhe vajzat: "Çdo grua që përballet me dhunën duhet të gjejë forcën të denoncojë, sepse ne do të dëgjojmë dhe mbështesim secilën prej tyre, në çdo kohë. Në çeljen e fushatës kundër dhunës me bazë gjinore, merrnin pjesë edhe përfaqësues të lartë të organizatave ndërkombëtare, z. Giuseppe Belsito, drejtor i UN Women në Shqipëri, z. Brian William, përfaqësues i OKB për Shqipërinë si dhe aktivistë e përfaqësues të shoqërisë civile.

**Tirana International Airport**  
Nënë Tereza

**TENDER OPPORTUNITY FOR DUTY FREE BUSINESS AT TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA)**

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

**DUTY FREE**  
• Approx. 282 m2;

**Prospective tenants are expected to meet the following requirements:**

- Qualification and Experience with the object "Duty Free Management" (interested parties must provide examples / references); Information must be provided on similar current activities, number, size and location of outlets, years of operation, annual turnover in the last three years (or from the date of operation), total number of employees;
- Financial solidity, excellent standing and capability of the company; minimum relevant turnover in the last financial year of EUR 1,000,000 in the relevant field (interested parties must provide Profit & Loss statement of last three years);
- Relevant software/IT and data management experience concerning the Duty Free system used in the duty free areas managed by the company (interested parties must provide examples / references);
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal and sign the Confidentiality Commitment Document, which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas;
- Only to the companies that will submit the confidentiality commitment will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals;
- The Request for Proposal will be distributed only on 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time, which, documents will be delivered in a CD, free of charge.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address not later than 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time:

**Tirana International Airport N'n' Tereza S.H.P.K**  
Administration Building  
Commercial & Property Department  
Rinas, Albania

Emails:  
Commercial Department  
Legal Department  
Procurement Department

Alisa Gjinari  
Ilir Alimema  
Albi Palushi

agjinari@tirana-airport.com  
ialimema@tirana-airport.com  
apalushi@tirana-airport.com

## Kryebashkiaku: 62 shkolla qëndrojnë hapur pas mësimit

### Shkollat si qendër komunitare, çelet palestra te "Dëshmorët e Lirisë"

Në vijim të nismës "Shkollat si qendër komunitare", Bashkia e Tiranës, çeli dyert e palestrës së re të shkollës "Dëshmorët e Lirisë" duke ftuar jo vetëm nxënësit e saj, por edhe të rinjtë e njësive, të merren me sport, si mënyra më e mirë për të pasur një jetë më të shëndetshme. Kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj dhe ministri i Diasporës, Pandeli Majko theksuan se palestra e rikonstruktuar e shkollës është një ftesë për çdo të ri dhe re që të heqë dorë nga jeta sedentare dhe të merren me aktivitetet sportive. "Kjo është 1 nga 62 shkollat, e cila qëndron e hapur edhe pas mësimit, ku po të njëjtët nxënësit apo edhe nxënësit tjerë nga komuniteti kanë mundësi të përdorin terrenet sportive. Palestrën këtu e përdorim kryesisht për voleyboll, basketboll, taekwondo. Disa nga klasat do t'i përdorin për kurse shahu, ndërsa pjesa e fushës jashtë për kalçeto ose futboll", tha Veliaj. Ai theksoi se palestret dhe mjediset e tjera të shkollës ofrojnë mundësi për çdo kategori apo disiplinë sportive, ndaj shtoi



se është e rëndësishme që fëmijët dhe nxënësit të regjistrohen në kurset e hapura. "Fakti që kemi të paktën 5 sporte të ndryshme që gjallërojnë hapësirën e shkollës është diçka shumë e mirë. Jam i sigurt se nuk do të bëhemi të gjithë kampionë, por punë e madhe edhe po s'u bëjmë kampionë; rëndësi ka që të jemi qytetarë kampionë! Do të thotë të mësojmë si të luajmë në skuadër, të mësojmë si të humbasim, është pjesë e jetës, të mësojmë si të fitojmë; pra të jemi të përlulur kur fitojmë dhe rëndësi ka që të gjithë të bëhemi shokë me njëri-tjetrin", shtoi Veliaj. Kryebashkiaku theksoi faktin se edhe rikonstruksioni

i shkollës dhe i palestrës tregoi edhe një herë se Tirana është si një familje e madhe ku të gjithë kontribuojnë për ta bërë atë më të mirë. Veliaj ftoi të rinjtë të bëhen pjesë dhe të mbështesin dy nismat e tjera të Bashkisë së Tiranës, atë për të festuar festat kombëtare të Nëntorit, duke nxjerrë nga një flamur në ballkonin e shtëpisë, si dhe duke mbjellë qoftë edhe një pemë. Ministri i Diasporës, Pandeli Majko vlerësoi nismën për të hapur palestret dhe shkollat për komunitetin edhe pas orarit të mësimit dhe u shpreh se duke u marrë me sport fëmijët e Tiranës do bëhen qytetarë më të mirë nesër.





Studentët e "Luarasit" pranë familjes në Pasku.

Familja: Falënderime pafund për studentët. Studentja: Të bashkohemi të gjithë në këtë mision

Voltiza Duro

Nëpërmjet një akti bamirësie, studentët e senatit të universitetit "Luarasi" dhanë kontributin e tyre për një familje në nevojë në zonën e Paskuanit në kryeqytet. "Ne jemi të vegjël, por së bashku mund të bëjmë gjëra të mëdha". Nën këtë moto, senati akademik i Luarasit, nën praninë e pedagogëve zgjodhën të ndihmonin me veshje, ushqime e shumë dashuri familjen që jeton në kushte ekstreme jetese. Me lot në sy, nëna e familjes Qefalio falënderoi studentët e Luarasit për gestin human. "Burrin e kam invalid, vetë jam e sëmurë, me fëmijë të vogël e nuk kemi mundësi me aq pension sa merr burri. Çfarë të bëj, të paguaj ujën, dritat, a të veshim fëmijët apo të marrim ilaçet për mua e burrin? Shumë faleminderit që më ndihmuat, më keni respektuar mua e familjen time", -thotë gruaja. Studentët e universitetit "Luarasi" kishin përgatitur edhe një dhuratë për djalin e familjes Qefalio. "Kjo është një dhuratë e vogël për ty, dhe ndoshta kur të rritesh do të bëhesh një student shumë shumë i mirë dhe do të ndihmosh edhe mamën e babin", -iu drejtua njëra prej studenteve djaloshtit 13 vjeçar. Më tej, pedagogu në Fakultetin e Drejtësisë, Lisien Damini i ka premtuar 13-vjeçarit që pas disa vitesh, mund të bëhet pjesë e Luarasit nëpërmjet bursave të nevojës që ky universitet ofron për shtresat në nevojë. "Kur të rritesh edhe pak mund të bëhesh pjesë e universitetit "Luarasi" pasi ne japim edhe bursa për shtresa të caktuara. Kështu që edhe ti mund të jesh student shumë i mirë

# Studentët e "Luarasit" pranë familjeve në nevojë, ndihmë me veshje e ushqime

## Lisien Damini: Vetëm fillimi, nisma do të vazhdojë



Studentët e "Luarasit" duke ndihmuar familjen në nevojë



qipëri. Ky është vetëm aktiviteti i parë dhe ne formuam Klubin e Vullnetarëve, senati bashkë me zyrën e studentëve dhe do jemi në vazhden e këtyre aktiviteteve në mënyrë të vazhdueshme", -theksoi Lisien Damini. Ndërkohë edhe pedagogia e fakultetit ekonomik në universitetin Luarasi, Resina Pllaha tha se sa më shumë studentët të bashkohen, aq më shumë gjëra të bukura mund të bëhen. "Sikur një student në një javë të heqë një kafe, mund të pijë një kafe më pak, e të ofrojë një ndihmë më shumë. Kështu që le të bashkohemi të gjithë, sepse ndoshta jemi shumë të vegjël por kur bashkohemi bëjmë gjëra shumë të mëdha", -shprehet pedagogia. Studentët e "Luarasit" i bëjnë thirrje të gjithëve që kanë mundësi që të ndihmojnë sadopak këtë kategori të shoqërisë. "Dua të them që nuk do të jetë nisma e parë. Uroj që të gjithë, kushdo që mund të kontribuojë sadopak, ta bëjë për çdo njeri që ka nevojë", -thekson studentja Xhesika Picari. Në muajin dhjetor, studentët e universitetit "Luarasi" kanë planifikuar të organizojnë një aktivitet bamirësie për të dhënë kontributin e tyre për familjet në nevojë.

**KLUBI I VULLNETARËVE**  
"Studentët e senatit në bashkëpunim me disa studentë të tjerë mblodhën disa ndihma simbolike për të ndihmuar këtë familje në nevojë. Ky është vetëm aktiviteti i parë dhe ne formuam Klubin e Vullnetarëve, senati bashkë me zyrën e studentëve dhe do jemi në vazhden e këtyre aktiviteteve në mënyrë të vazhdueshme", -theksoi Lisien Damini.

**"LE TË BASHKOHEMI"**  
"Sikur një student në një javë të heqë një kafe, mund të pijë një kafe më pak, e të ofrojë një ndihmë më shumë. Kështu që le të bashkohemi të gjithë, sepse ndoshta jemi shumë të vegjël, por kur bashkohemi bëjmë gjëra shumë të mëdha", -shprehet pedagogia.

i Luarasi-t", -i tha pedagogu djalit të familjes Qefalia. Ndërkohë, pedagogu Fabian

Pjetri i ka uaruar shërim të shpejtë kryefamiljarit dhe ka theksuar se do të rikthe-

hen sërisht të kjo familje për ta ndihmuar. "Zotërisë i uroj shërim sa më të shpe-

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 11.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i Il-te per shiten e pasurise te paluajshme, Apartament me Nr.pasurie.6/143+1-38 me adresë "Lagja 16 Prilli", me sipërfaqe totale 120 m<sup>2</sup>, Zona Kadastrale Nr.8534, Vol.8, Fq.161. Fier në pronësi të z.Mihal Jorgo Gjukuris me vlerë fillestare në ankand 30.240 (Trihjet mijë e dyqind e dyzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I-re per shiten e pasurise te paluajshme, Arë me sipërfaqe 1500 m<sup>2</sup>, nr. 179/87, vol. 8, fq. 19 zk. 2326, në Kuman, Fier në pronësi të Z. Arben Refat Ramizi me vlerë fillestare në ankand 600.000 (Gjashtëqind mijë) Lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

**SHPLLJE ANKANDI**  
Zyra Perbarimore "E.G Bailiff Service" me perbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Ruova, Pall 64, Hyrja 8, Ap 1, Tirane, njofton se me date 14.12.2018 ora 8<sup>00</sup> - 16<sup>00</sup> ne ambientet e saj, do te zhvillohet: Ankandi i I-re per shiten e pasurise te paluajshme, Trull me sipërfaqe 1000 m<sup>2</sup> ndodhur në ZK. 2399, Nr. 281/20, Vol. 13, fq. 9 nga kjo Ndërtesë me sipërfaqe 134 m<sup>2</sup> në pronësi të Z. Ilir Alush Uku me vlerë fillestare në ankand 8.000.000 (Tetë milion) lekë. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

## Thaçi në SHBA, pritet takimi me Pompeo e Bolton

### Hyrja në BE dhe dialogu me Serbinë, presidenti i Kosovës viziton krerët e lartë amerikanë

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi është nisur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për vizitë zyrtare, ku do të takohet me përfaqësues të lartë të Shtëpisë së Bardhë, të Departamentit të Shtetit, Kongresit, Senatit, si dhe me personalitete që kanë mbështetur Kosovën. "Në Shtëpinë e Bardhë, presidenti Thaçi do të zhvillojë një takim me John Bolton, Këshilltar për Siguri Kombeve të Bashkuara në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me Sekretarin e Departamentit të Shtetit, Mike Pompeo", thuhet në njoftimin e Zyrës së



Presidentit. Në këto takime, presidenti Thaçi pritet të bisedojë për marrëdhëniet

dypalëshe, për perspektivën euroatlantike të Kosovës si dhe për arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese me Serbinë, e cila siç thuhet, "i siguron njohje nga Serbia dhe i hap rrugë për anëtarësim në BE, NATO dhe OKB", thuhet tutje në njoftim. Gjatë qëndrimit në SHBA, Thaçi po ashtu pritet të ketë një takim në Dallas me ish-presidentin George W. Bush si dhe me komunitetin shqiptaro-amerikan atje. Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj është shprehur i gatshëm të japë

dorëheqjen nëse Kosova bashkohet me Shqipërinë. Mbrëmjen e së shtunës, i ftuar në "Xing me Ermalin" Haradinaj ka folur për jetën e tij duke nisur nga puna në emigrim deri tek martesat dhe karriera politike. I pyetur nga Ermali se në qoftë se bashkohet Shqipëria dhe Kosova kush do ta japë dorëheqjen ai apo Rama, Haradinaj tha "E jap unë. Po pse jo" shumë spontan për të treguar se më i rëndësishëm se gjithçka është bashkimi. Ankesave të moderatorit për kontrollin në të dyja anët e kufirit, Haradinaj iu përgjigj se nga 1 janari nga Kosova do të hiqet të gjitha kontrollat.

Bruksel, Juncker: Largimi i Britanisë së Madhe është një tragjedi

# Liderët e 27 vendeve të BE i hapin dritën jeshile "Brexit"

Tusk: Dalja nga Bashkimi Evropian pritet në 29 mars të 2019

Presidenti i Këshillit Europian, Donald Tusk ka njoftuar se marrëveshja për daljen e Anglisë nga Bashkimi Evropian ka marrë aprovimin e liderëve të unionit. Liderët e 27 vendeve të Bashkimit Evropian pas gjysmë ore diskutimesh ranë dakord ditën e djeshme për t'i hapur dritën jeshile këtij procesi. Ky proces tashmë do kalojë edhe në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, aty ku shumë deputetë janë kundër "Brexit". Kreu i KE, Donald Tusk e njoftoi lajmin në rrjetin social "Twitter". Britania pritet të largohet përfundimisht nga Bashkimi Evropian më 29 mars të 2019-s. Udhëheqësit e vendeve evropiane miratuan marrëveshjen për shkëputjen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian. I pari që e njoftoi ishte kreu i Këshillit Europian Donald Tusk, i cili nga samiti i Brukselit konfirmoi përmes Twitter-it se të 27 vendet anëtare pranuan marrëveshjen për daljen e Britanisë nga unioni. Para takimit, kreu i Komisionit Jean-Claude Juncker nuk e fshehu keqardhjen për këtë vendim. "Sot është një ditë e trishtuar, të shohësh një vend si Britania e Madhe të largohet, por do të bëja të njëjtin koment edhe për të gjithë të tjerët, distancimi nga BE-ja nuk është një moment gëzimi apo festimi, ky është një moment i trishtë, një tragjedi". Miratimi i marrëveshjes u vu në rrezik pas deklaratës së kryeministrit spanjoll Pedro Sanchez, i cili paralajmëroi se do të duhej bisedime shtesë me Spanjën dhe Britaninë për rishikimin e "Sovranitetit të përbashkët" mbi Gjibraltarin, tani që Londra largohet nga unioni. Megjithatë, Spanja e mbështeti marrëveshjen pas takimit me kryeministrave Sanchez e May. Më herët, kryeministria britanike Theresa May u dërgoi një letër të hapur kundërshtarëve politikë, ku thoshte se marrëveshja ishte në të mirë



#### JEAN-CLAUDE JUNCKER:

"Sot është një ditë e trishtuar, të shohësh një vend si Britania e Madhe të largohet, por do të bëja të njëjtin koment edhe për të gjithë të tjerët, distancimi nga BE-ja nuk është një moment gëzimi apo festimi, ky është një moment i trishtë, një tragjedi", ka thënë Juncker.

të interesit kombëtar të Britanisë së Madhe. Por sfida më e vështirë për shefen e qeverisë së Londrës tashmë është parlamenti britanik. Marrëveshja do të votohet në Dhomën e Ulët gjatë dhjetorit dhe May nuk ka as gjysmën e deputetëve që duhet ta mbështesin për ta miratuar marrëveshjen. Ndërkaq vetëm para disa ditësh Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk ka rekomanduar që Bashkimi Evropian të miratojë marrëveshjen për Brexitin, gjatë samitit që pritet të mbahet të dielën. Ky

njoftim vjen pasi kryeministria i Spanjës, Pedro Sanchez është siguruar nga qeveria e Mbretërisë së Bashkuar mbi Gjibraltarin dhe ka hequr dorë nga kërçërimi se do të bojkotojë samitin, raporton BBC. Ai tha se ka pranuar garanci të shkruar mbi rolin e Spanjës mbi të ardhmen e territorit britanik. Kryeministria britanike, Theresa May do të udhëtojë më vonë gjatë ditës drejt Brukselit, ku do të takohet me zyrtarë të lartë të BE-së para samitit. Ndërkaq, ish-sekretari i Jashtëm britanik, Boris Jonson



Barrikadat në flakë tërhoqën i morën gjithë vëmendjen atmosferës së krijuar nga zbulimet për festat e fundvitit në Paris. Këtë pamje të ofronte bulevardi qendror i kryeqytetit francez natën mes të shtunës dhe të dielës, në përfundim të protestës së të ashtuquajturve "Jelekë të verdhë", që protestojnë prej 2 javësh kundër rritjes së çmimit të karburanteve. Protesta e të shtunës me 19 të plagosur, 4 prej të cilëve policë. Policia njoftoi arrestimin e 40 protestuesve që u përfshinë në aktet e dhunës, nga 8 mijë që dolën në rrugë. Manifestimi u zhvilluan në gjithë Francën, me pjesëmarrjen e 100 mijë njerëzve.

ka thënë se Britania do të bëhet "një shtet satelit" nga kjo marrëveshje. Spanja kishte ngritur kundërshtime mbi mënyrën se si është trajtuar Gjibraltari deri më tani në bisedimet e Brex-itit. Por, liderët e BE-së kanë arritur një kompromis me kryeministrin spanjoll, i cili ka thënë se Evropa dhe Mbretëria e Bashkuar "kanë pranuar kushtet e vendosura nga Spanja", në mënyrë që të ketë votën pro për Brexitin. Tusk, përmes një letre drejtuar anëtarëve të Këshillit Evropian ka thënë se ai ka rekomanduar "që të miratojmë të dielën rezultatit e negociatave të Brex-itit". Ai ka shtuar se "askush nuk ka arsye që të jetë i lumtur. Por, të paktën në këtë moment kritik, BE-ja ka kaluar testin e unitetit dhe solidaritetit".

ra nga Spanja", në mënyrë që të ketë votën pro për Brexitin. Tusk, përmes një letre drejtuar anëtarëve të Këshillit Evropian ka thënë se ai ka rekomanduar "që të miratojmë të dielën rezultatit e negociatave të Brex-itit". Ai ka shtuar se "askush nuk ka arsye që të jetë i lumtur. Por, të paktën në këtë moment kritik, BE-ja ka kaluar testin e unitetit dhe solidaritetit".

## SHKURT



### Libi/ Sulm me armë në Cirenaica, 5 të vdekur

Atentati i Isis në Libi, ku një grup njerëzish të armatosur kanë hapur zjarr duke sulmuar një komisarjat në Tazirbu, në Cirenaica, ka shkaktuar vdekjen e 5 personave me të cilëve civilë dhe policë. Agresorët kanë marrë peng edhe disa njerëz përpara se të largoheshin nga vendngjarja. Lajmin e bëjnë të ditur burime vendase, të cilat citojnë dëshminë e një dëshmitari dhe një mjeku në spitalin lokal, sipas të cilëve grupi që ka bërë sulmin kishte karakteristikat e luftëtarëve të Shtetit Islamik.

### Ugandë, 29 të vdekur pas përmbysjes së anijes në liqenin Viktoria

Të paktën 29 persona kanë vdekur natën e kaluar pas përmbysjes së anijes me të cilën ata udhëtonin, në ujërat e liqenit Viktoria në Kampala, Uganda. Lajmin e ka bërë të ditur policia duke precizuar që gjatë operacionit janë shpëtuar 27, duke saktësuar se në bordin e anijes në momentin e përmbysjes ishin rreth 90 pasagjerë, gjë që të bën të mendosh se bilanci i viktimave është më i madh. Sipas zëdhënësit të policisë anija ishte shumë e dëmtuar dhe nuk kishte licencë lundrimi. Pavarësisht kësaj vazhdojnë të transportonte pasagjerë, të cilët bëni shëtitje turistike në liqen, shumë i populluar mbi të gjitha nga të rinjtë gjatë fundjavës.

### Britani, qindra bebe lindin me varësi nga droga

Britania jep alarmin për numrin në rritje të të miturve që lindin të varur nga droga. Sipas statistikave, vetëm në Skoci rreth 600 fëmijë brenda 3 viteve kanë lindur me simptoma të shkaktuara nga abuzimi i grave shtatzëna me lëndët narkotike. Simptomat janë pasojë e drogave që nënat ua përcjellin fëmijëve të tyre që në fetus. Ato variojnë nga dridhje të pakontrolluara të fëmijëve të porsalindur, hiperaktivitet dhe të qara të forta. Të dhënat tregojnë tendencë në rritje nga viti në vit të fëmijëve të lindur me këto simptoma që prej vitit 2015.





## MJEKU POPULLOR



Ylli Merja: Si të kuroni diabetin me çajin bimor, efektet e mrekullueshme

## KESHILLA



Pesë efektet e qumështit në lëkurën e fytyrës

# Gerald Kola:



◆ Mjeku i përgjithshëm: Fëmijët dhe të moshuarit, kategoritë më të riskuara

## Si të shpëtoni nga gripi brenda një kohe të shkurtër

"Kujdes me përdorimin e antibiotikëve, konsultohuni me mjekun

•Vetitë e kurës me kamomil e vaj ulliri

Mjeku i përgjithshëm: Fëmijët dhe të moshuarit, kategoritë më të rriskuara

# Gerald Kola:

## Si të shpëtoni nga gripi brenda një kohe të shkurtër

**"Kujdes me përdorimin e antibiotikëve, konsultohuni me mjekun"**

Voltiza Duro

**G**ripi është një sëmundje virale, në dukje e padëmshme, por që ka shkaktuar miliona viktima në historinë e njerëzimit. Në një intervistë për suplementin "Life Pages" në "Gazeta Shqiptare", mjeku Gerald Kola thekson se gripi nuk duhet trajtuar si një gjendje kalimtare. Ai bën me dije se një kujdes i veçantë duhet treguar ndaj personave me imunitet të dobët si fëmijët e vegjël (0-12 vjeç); moshën e tretë (mbi 60 vjeç) dhe personat që vuajnë nga sëmundjet kronike. Kola thekson se në momentin e parë që personi i shfaqen simptomat, ai duhet të përdorë antiviralët pasi zvogëlojnë mundësitë e përhapjes së mëtejshme të virusit në organizëm.

### Cfarë duhet të bëjmë kur konstatojmë simptomat e para të gripit?

Gripi i zakonshëm është një sëmundje virale, kryesisht e përhapur gjatë stinës së dimrit, megjithëse kohët e fundit për shkak të ndryshimeve klimatike të planetit tonë dhe ndryshimit të menjëhershëm të temperaturave shfaqet edhe në stinët e tjera. Madje po t'i referohemi verës së vitit që sapo lamë pas, kanë qenë mjaft të shpeshta rastet e prekura nga gripi stinor. Simptomat e gripit janë kryesisht rinietë (rrjedhje hundësh), lotim i syve, djegie fyti, kollë, dhimbje muskujsh dhe koke dhe tem-

peraturë e lartë mbi 38-39. Në disa raste, gripi mund të shoqërohet dhe me të përziera dhe të vjella, sidomos tek fëmijët e vegjël. Kujdes, eliminoni përdorimin e antibiotikëve pa rekomandimin e mjekut.

### Cilat janë kategoritë më të rriskuara?

Zakonisht sëmundjet virale prekin më shumë dhe në formë më

të cilat vuajnë shpesh të moshuarit. Tek personat me imunitet të dobët, si ata të prekur nga HIV/AIDS ose ata që kanë realizuar transplante, sëmundjet virale mund të shfaqen në formë të rrezikshme. Gjithashtu, personat që vuajnë nga bronkiti kronik apo astma mund të përkeqësohen ndërsa janë të prekur nga gripi. Duhan-



Mjeku i përgjithshëm Gerald Kola



të rëndë fëmijët e vegjël (0-12 vjeç), moshën e tretë (mbi 60 vjeç) dhe personat që vuajnë nga sëmundjet kronike. Kategoria e parë, fëmijët, janë më të predispozuar të preken, pasi imuniteti i organizmit të tyre është më i dobët, sesa i të rriturve, ndërsa tek moshat e treta gripi stinor komplikohet edhe më tepër për shkak të sëmundjeve kronike nga

pirja është një tjetër faktor rrisht, pasi kur është e shoqëruar me sëmundje serioze rrit vdekshmërinë nga gripi.

### Mund të na tregoni disa prej formave të trajtimit të gripit?

Sapo filloni të ndjeni simptomat e para të gripit (rinietë, lotim sysh, dhimbje fyti, koke apo muskujsh, kollë etj.), nisni të përdorni anti-

virale si aspirina C, gripostad, tylohot, ferverx, rinostop, kafetine Cold, daleron Cold, zerinol flu etj. Përdorimi i këtyre antiviralëve zvogëlon mundësitë e përhapjes së

dojë mjekimin e duhur.

### Si përhapet kjo sëmundje virale?

Gripi është një sëmundje virale aerogjene, pra përhapet me anë të ajrit dhe, për këtë arsye, në vendet ku janë të përqendruar një numër i madh personash (shkolla, reparte apo zyra me shumë punonjës) shpesh të mënyrë progresive mundësia që virusi të përhapet më shpejt sesa në ambiente me pak njerëz. Nëpërmjet teshtitjes apo kollitjes, personi i infektuar mund të përhapë në ajër virusin, i cili mund të bjerë menjëherë në kontakt me hundën, sytë apo gojën e personit të shëndoshë. Për të mos u prekur nga sëmundjet virale, këshillohet larja e shpeshtë e duarve me sapun, sidomos nëse ndodheni në ambiente me persona të sëmurë. Jetëgjatësia e virusit në sipërfaqe të caktuara varion; kështu në objekte si metale apo plastikë ai mund të mbijetojë deri në dy ditë, por mund të mbijetojë vetëm 15 minuta në sipërfaqe letre dhe 5 minuta në lëkurë. Nëse qëndroni për një kohë të gjatë në një ambient me një person të prekur nga gjendja virale, mundësia për t'u prekur rritet ndjeshëm. Zakonisht simptomat e para të gripit shfaqen brenda 24 orëve, pasi organizmi është prekur nga virusi dhe ato vazhdojnë për rreth 5-7 ditë. Gjendja gripale paraqitet më e theksuar ditën e dytë dhe të tretë pas infektimit, ditë kur zakonisht shfaqen edhe ethet e temperatura e lartë. Në shumicën e rasteve gjendjet virale neglizhohen nga të prekurit, pasi mendojnë se është një sëmundje që kalohet lehtë. Por

mëtejshme të virusit në organizëm dhe ju ndihmon të kaloni më lehtë sëmundjen. Nëse gripi shoqërohet me temperaturë të lartë, rekomandohet përdorimi i paracetamolit. Antiviralët përdoren çdo 4 apo 6 orë në varësi kjo të progresit të sëmundjes. Nëse keni temperaturë të lartë, kryeni një vizitë tek mjeku, pasi vetëm ai mund t'ju rekoman-



kujdes, pasi gripi mund të shoqërohet me komplikacione të rënda shëndetësore, të cilat mund të përkeqësohen aq shumë saqë të çojnë deri në vdekjen e të sëmurit. Në rastet kur gripi prek një person me imunitet të dobët apo që vuan nga sëmundje kronike, duhet pasur shumë kujdes, pasi mund të përballlemi me pasoja shumë të rrezikshme. Virusi i gripit, kur prek organizmin, tenton të godasë organet me imunitet më të dobët e për pasojë, një grip i thjeshtë mund të krijojë dëme të shumta, duke rrezikuar dhe jetën e njeriut. Ka mjaft raste gripi që, kur nuk marrin mjekimin e duhur, kalojnë në ftohje e deri bronkopneumoni, që kërkojnë një mjekim mjaft të kujdesshëm dhe shumë më të gjatë.

#### A ndihmon në parandalimin e gripit vaksina?

Vaksina antigrip këshillohet të merret nga të gjitha moshat, po kryesisht nga fëmijët, të moshuarit dhe të sëmurët kronikë në periudhën kohore fundi i muajit shtator - fillimi i tetorit, që përkon me kohën kur nisin ndryshimet e para të temperaturave dhe shfaqen simptomat e sëmundjeve virale. Për shkak të mutacioneve që mund të pësojë virusi, vaksina nuk jep efekt për më shumë se një vit. Për këtë arsye Organizata Botërore e Shëndetësisë parashikon se cilët viruse do të qarkullojnë në ajër vitin e



dur më lart dhe herën e dytë, pas një muaji, pra në fillim të muajit nëntor. Vaksina antigrip përmban rreth 5-6 lloje virusesh virale që janë shfaqur në vende të ndryshme të planetit tone një vit më

Shumë persona, në rastet kur konstatojnë se janë prekur nga gripi nisin të mjekojnë veten me antibiotikë pa u konsultuar më parë me mjekun personal. Një gjë e tillë është mjaft e dëmshme për organizmin pasi gripi është një sëmundje virale dhe viruset nuk janë të ndjeshëm ndaj antibiotikëve. Përdorimi pa vend i tyre ul imunitetin e trupit të njeriut duke ndihmuar kësh-tu në përparimin e virusit.

ardhshëm e pas kësaj lejon shoqëritë farmaceutike të krijojnë vaksinat që garantojnë mbrojtjen më të mirë ndaj këtyre viruseve. Në rast se e bëni vaksinën për herë të parë duhet ta bëni atë dy herë; një herë në periudhën e përmën-

parë. Bërja e vaksinës nuk të bën imun ndaj gripit, pra nuk nënkupton se nuk do të prekeni nga gripi, por garanton një prekje më të lehtë nga virusi. Nëse një person që nuk e ka bërë vaksinën i ndjen pasojat e gripit përreth 4-5 ditë, një



person i vaksinuar i ndjen ato përreth 1-2 ditë. Tek fëmijët 0-3 vjeç duhet të injektohet vetëm gjysma e

dozës që merr një person i rritur.

#### A mund të marrim antibiotikë pa rekomandimin e mjekut?

Në asnjë rast antibiotikët nuk duhen përdorur pa rekomandimin e mjekut. Shumë persona, në rastet kur konstatojnë se janë prekur nga gripi nisin të mjekojnë veten me antibiotikë pa u konsultuar më parë me mjekun personal. Një gjë e tillë është mjaft e dëmshme për organizmin pasi gripi është një sëmundje virale dhe viruset nuk janë të ndjeshëm ndaj antibiotikëve. Përdorimi pa vend i tyre ul imunitetin e trupit të njeriut duke ndihmuar kësh-tu në përparimin e virusit. Antibiotikët përdoren vetëm në rastet kur influenza virale është e shoqëruar me komplikacione, por dhe në këto raste rekomandohet gjithnjë vizita më parë tek mjeku, i cili është i vetmi person që mund të rekomandojë përdorimin e një antibiotiku të caktuar për kurimin e sëmundjes.

#### Cilat janë këshillat tuaja për të sëmurët me grip?

Personat e prekur nga gripi këshillohet të pushojnë, të qëndrojnë në shtëpi për 1-2 ditë, të pinë shumë lëngje, të evitohen përr-

jen e alkoolit apo duhanit dhe të përdorin paracetamol për të ulur temperaturën dhe për të pushuar dhimbjen e muskujve. Fëmijët dhe adoleshentët që shfaqin simptomat e gripit duhet të evitohen përdorimin e aspirinës, pasi ajo mund të shkaktojë sindromën Reye, një sëmundje shumë e rrezikshme për mëlçinë.

#### Cilat janë pasojat më të rënda nga gripi?

Në rastet kur gripi përhapet me një shpejtësi të madhe, prek një numër shumë të madh njerëzish dhe shkakton mjaft viktime atëherë kemi të bëjmë me pandemi. Pandemia më e rëndë e gripit e regjistruar deri tani në historinë e njerëzimit është ajo e viteve 1918-1919, e njohur ndryshe si gripi spanjoll. Ky grip (i tipit A, H1N1), megjithëse nuk dihet saktësisht sesa jetë njerëzish mori, mendohet se ka shkakuar vdekjen e 20 deri 100 milionë njerëzve. Ai u quajt ndryshe holokausti më i madh mjekësor në historinë dhe shkaktoi më shumë të vdekur sesa lufta e parë botërore, që sapo kishte përfunduar. Në muajt e parë të përhapjes së tij, gripi u ngatërrua me sëmundjen e kolerës, pasi dhe simptomat që ai shfaqte ishin të ndryshme nga ato të gripeve të mëparshme. Sipas dokumenteve të asaj kohe, shumë prej të prekurve shfaqnin komplikacione që shoqëroheshin me hemorragji nga hundët, stomaku apo zorrët. Gjithashtu, raste të shumta janë verifikuar me gjakrrjedhje nga veshët apo hemorragji të lëkurës. Gripi spanjoll pati një përhapje globale, nga Arktiku e deri tek ishujt e Paqësoris. Shumë prej të prekurve vdiqën nga komplikacionet shëndetësore si pneumonia bakteriale, një infeksion dytësor i shkakuar nga gripi. Një tjetër anomalë që shfaqti kjo pandemi në krahasim me rastet e tjera të gripit të njohura kudo në botë ishte numri i lartë i vdekshmërisë mes popullsisë me moshë 20-40 vjeç. Në të gjitha rastet e tjera kjo grupmoshë i ka përballuar simptomat dhe komplikacionet e gripit të zakonshëm më lehtë sesa dy grupmoshat e tjera të rrezikuara; fëmijët e vegjël dhe të moshuarit. Sipas statistikave mendohet se në vitet 1918-1919, rreth 2.5 deri 5% e popullsisë botërore gjeti vdekjen si pasojë e kësaj pandemie. Pandemita e tjera të gripit, gripi aziatik (i tipit A, H2N2, i shfaqur në 1957) dhe gripi i Hong Kongut (i tipit A, H3N2 i shfaqur në 1968) nuk qenë kaq të rënda sa ato të gripit spanjoll. Megjithëse nuk patën fuqinë e gripit spanjoll edhe prej tyre gjetën vdekjen miliona njerëz.



Voltiza Duro

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetit deri në vitin 2014 janë diagnostikuar 422 milionë njerëz që vuajnë nga diabeti. Procesi i balancimit të sheqerit në organizmin e njeriut fillon me ushqimin. Kur ne konsumojmë një ushqim ai kthehet në glukozë në organizëm. Më pas kjo glukozë futet në gjak dhe shkon në pjesë e madhe e saj si energji për trurin dhe zemrën, një pjesë shkon nëpër të gjitha qelizat e tjera në trup, të cilat duhet të ushqehen. Nëse kemi konsumuar më shumë kalori sesa i duhet një njeriu atëherë një pjesë fillon të depozitohet në formën e yndyrës. Në momentin kur sheqeri tretet, pankreasi hyn në veprim dhe sekreton insulinë në gjak. Insulina ndihmon në rregullimin e depozitimit të sheqerit dhe yndyrave në organizëm. Kur sasia e sheqerit në gjak rritet, pankreasi çliron insulinën, e cila vepron mbi qelizat duke i stimuluar ato të përthithin dhe përdorin këtë sheqer. Qelizat stimulohen të përdorin gjithmonë sheqerin si burim i parë i energjisë. Pra, nëse ne sot kemi konsumuar një pjatë me supë me një fetë bukë, dhe pak fruta kemi marrë mjaftueshëm sheqerna për këtë vakt të caktuar. Në këtë rast pankreasi prodhon insulinë për të ndihmuar tretjen dhe çdo gjë është në normalitet, qelizat e trupit fillojnë ta harxhojnë sheqerin për "punët" e ditës. Nëse ne konsumojmë një pjatë supe me gjalpë, me 3 feta bukë, 1 gotë pije me gaz, pastaj konsumojmë një copë tortë me çokolatë të shokëruar me një gotë me pije me gaz, dhe në fund 2-3 fruta, atëherë ky është një vakt i ngarkuar. Kemi marrë shumë kalori, të cilat përmbajnë shumë sheqerna. Në këtë rast pankreasi ngarkohet të prodhojë më shumë insulinë për të rregulluar tretjen e këtij sheqeri që ka hyrë në organizëm. Nëse pankreasi do e bëjë këtë punë një herë në muaj apo në 2 muaj, kjo nuk është e lodhshme. Por nëse pankreasi do e bëjë këtë mbilodhje 2-3 herë në javë, apo akoma më keq 2 herë në ditë atëherë ai fillon të dobësohet në funksion. Kështu fillon sëmundja e diabetit. Insulina ndihmon që sheqeri të kalojë në lehtësi membranën qelizore, shtresat e yndyrës dhe të gjitha indet e tjera. Gjithashtu, insulina stimulon mëcinë të depozitofej sheqerin në formën e glukogjenit. Duke pirë një shishe në ditë me pije me gaz rritni kështu rrezikun tuaj për të pasur diabet me 22%. Sëmundja e diabetit ndahet në disa lloje. Tipi I, është diabeti që shfaqet në fëmijëri. Në këtë



Mjeku popullor: Cilat janë tipat e sëmundjes. Simptomat kryesore dhe diagnostikimi

## Ylli Merja: Si të kuroni diabetin me çajin bimor, efektet e mrekullueshme

*"Përdorni uthullën e mollës dhe magnezin"*



Mjeku popullor Ylli Merja

rast trupi nuk prodhon fare insulinë. Afërsisht 10% e njerëzve që kanë diabet e kanë tipin I. Ndërkohë, tipi II ndodh kur organizmi nuk i përgjigjet insulinës, dhe rritet niveli i sheqerit në gjak, ose trupi nuk e prodhon më insulinën. Kjo sëmundje shfaqet në moshë të rritura. 90% e njerëzve e kanë tipin 2. Ky lloj diabeti mund të shfaqet edhe gjatë shtatzënisë, por që kalon pas lindjes.

### Simptomat

Shenjat e para të shfaqjes së diabetit janë: etje e shumë, dhe konsumim uji më shumë

se normalisht; rritje e oreksit; tharje e gojës; urinim i shpeshtë; ndjesi lodhje dhe këputjeje gjithë kohën edhe pse keni ngrënë ushqim; probleme me shikimin, nuk shikoni qartë; dhimbje koke të shpeshta; humbje në peshë të menjëhershme ose rritje në peshë.

Për të matur diabetin duhet të matni sheqerin në gjak para dhe pas ushqimit. Mund të bëhet një analizë urine, dhe nëse albuminat janë shumë të larta kjo tregon që ju mund të keni diabet. Ky i fundit në organizëm shkakton probleme në sistemin nervor, dobësimi shikimi; humbje në peshë; rritje të aciditetit të

stomakut; probleme me frymëmarrjen; ndjesia e të vjellit, dhe dhimbje stomaku; dobëson veshkat, mund t'i nxjerrë jashtë funksionit; tension të lartë, atak në zemër, dobësim të zemrës; shkakton impotencë tek meshkujt; plagët nuk shërohen.

### Trajtimi me bimë mjekësore

Mundohuni të mos bëni jetë sedentare. Mënyra e të ushqyerit dhe sporti janë ilaçi më i fuqishëm kundër diabetit. Ulni sasinë e përdorimit të sheqerit. Mos përdorni sheqer të përpunuar, por sheqerin kaf që është natyral. Mos përdorni makarona, patate e brumëra, sepse përmbajnë sasi të larta karbohidratesh. Eliminoni alkoolin,

sepse rrit tmerrësisht shumë nivelin e sheqerit në gjak dhe dëmton mëcinë, duke ndihmuar në çrregullimin e mekanizmit të largimit të sheqerit nga gjaku. Shtoni në dietë ushqime të pasura me fibra si: avocado, spinaq, fara të thata, bajame, fara liri, frutat me tul etj. Përdorni ushqime që përmbajnë krom në sasi të lartë, pasi kromi është i përfshirë në metabolismin e yndyrave dhe karbohidrateve dhe ndihmon punën e insulinës. Ushqimet që përmbajnë janë brokoli, djathi, jeshillëqet, mishi i vogël. Ushqimet që përmbajnë magnez ndihmojnë në metabolismin e glukozës. Ushqimet që përmbajnë magnez janë: fara kungulli, bajame, kosi, fasulla, spinaq etj. Konsumoni proteina, pasi ato ndihmojnë në uljen e absorbimit të sheqerit nga trupi. Pra, peshku, mishi, veza etj.

Përdorni uthull mollë të egër 1 lugë gjelle në ditë.

### Çaji i diabetit

Pas shumë e shumë përpjekesh për të ulur sheqerin në gjak, dhe pas shumë eksperimenteve të ndryshme kemi arritur që të gjejmë një përzjerje bimore që ndihmon në uljen e sheqerit në gjak. Çaji i diabetit përmban bimë që ndihmojnë në uljen e sheqerit, pa asnjë efekt anësor dhe nuk ndërvepron me medikamentet. Pra, mund të përdoret paralelisht edhe me ilaçet. Përgatitja e çajit: 1 paketë me çaj diabeti dhe 1 lugë gjelle molle e egër hidhen në ujë të valuar, lihet të ziejë përzjerja për 3-4 minuta, mbulohet derisa ftohet. Çaji pihet pa sheqer para ushqimit 3 gata në ditë.



# Këshilla

## Pesë efektet e qumështit në lëkurën e fytyrës

**Q**umështi është një burim i pasur i kalciumit dhe proteinës dhe renditet në ushqimet më të shëndetshme për njeriun. Qumështi jo i pasterizuar dhe i paskremuar i vjen në ndihmë lëkurës në mënyra nga më të ndryshmet.

### Kundër rrudhave

Me kalimin e moshës, lëkura e fytyrës hollon dhe humbet elasticitetin. Rrudhat shfaqen më shpejt ndërsa lëkura vuan pasojat e ekspozimit në diell. Qumështi përmban acid laktik që përmirëson shëndetin e lëkurës dhe zbut rrudhat. Falë qumështit, lëkura bëhet më e lëmuar dhe më e plotë.

### Qumështi për heqjen e qelizave të vdekura

Heqja e qelizave të vdekura të lëkurës është e domosdoshme.

Acidi laktik ndihmon në heqjen e tyre pa e dëmtuar më tej lëkurën, siç ndodh me eksfoliantët e tjerë me bazë kimike. Qumështin mund ta vendosni direkt në lëkurë. Nëse ajo është e yndyrshme, kura me qumësht duhet përdorur 3-4 herë në javë. Lëkurat e ndjeshme duhet të fërkojnë lëkurën me qumësht një ose dy herë në javë.

### Kundër dëmtimeve nga dielli

Ekspozimi në diell shkakton dëme të shumta në lëkurë. Një gjë e tillë e hollon lëkurën dhe zbeh elasticitetin e saj.

Acidi laktik zhbën dëmin e shkaktuar nga dielli dhe trash shtrësën e jashtme të saj. Për më tepër, ky acid nxit prodhimin e kolagenit, një proteinë që i jep



lëkurës paraqitje të shëndetshme. Antioksidantët tek qumështi janë shumë të mirë edhe për të lehtësuar dhimbjet nga të djegurat prej diellit dhe inflamacionin.

### Qumështi kundër njollave

Pigmentimi i lartë i lëkurës, njollat dhe crregullimet e tjera në paraqitjen e saj vijnë si pasojë e melaninës, një pigment që prish njëtrajtshmërinë e lëkurës. Qumështi dhe acidi laktik ulin sasinë e depozitave të melaninës në lëkurë duke e zbardhur atë dhe ofruar një paraqitje më të rregullt të saj.

### Qumështi ushqen lëkurën

Acidi laktik e ushqen lëkurën për aq sa ajo ka nevojë.

Yndyrat tek qumështi krijojnë një shtresë mbrojtëse për lëkurën dhe e zbusin atë. Qumështin mund ta vendosni çdo ditë në lëkurë për një ushqyerje të mirë e të plotë të saj. Ekspertët thonë se përtej përfshirjes së qumështit në përkujdesjen ndaj lëkurës, njeriu duhet ta pijë atë rregullisht. Qumështi i skremuar ndihmon kundër akneve dhe konsumi për mbi 3 muaj i tij përmirëson dukshëm paraqitjen e lëkurës.



## Vetitë e kurës me kamomil e vaj ulliri

**V**etitë janë të shumta, duke nisur nga problemet me lëkurën e deri tek pastrimi i enëve të gjakut. Një studim i ri, të cilit i referohet edhe Agroëeb.org, sugjeron se kamomili mund të parandalojë rritjen e nivelit të sheqerit në gjak. Diçka e tillë ndihmon në parandalimin dhe lehtësimin e komplikimeve që sjell sëmundja e diabetit. Lulet e kamomilit janë përdorur për çajra qetësues, dhe për të luftuar ankthin e stresin. Vaji me lule kamomili, ndihmon të gjithë sistemin kardiovaskular. Ai lehtëson qarkullimin e gjakut, e pastron atë nga ngurtësimet e qelizave të gjakut (tromboza) dhe përshepton procesin e oksigjenimit të tij. Si të përgatisim vajin me lule kamomili? Për këtë kurë mund të përdorni lule kamomili të thara. Mund t'i blini në farmacitë bimore, ose të përdorni kamomilit të freskët. Nëse përdorni



kamomil të freskët, duhet të këpusni lulet nga pjesa tjetër e bimës. Në një kavanoz të madh qelqi, hedhim gjysmë litër vaj ulliri ekstra të virgjër, më pas shtojmë rreth 3-4 lugë të plota gjelle me lule kamomili. Me ndihmën e një luge të përzienit përbërjen, në mënyrë që lulet të jenë të zhytura plotësisht në vaj. Më pas e mbyllim kavanozin me kapak dhe duhet ta vendosim në një vend me dritë.

Përbërjen do ta lini kështu për dy javë, në këtë mënyrë lulet e kamomilit do të kenë lëshuar të gjitha enzimat e tyre tek vaji i ullirit. Pasi të kenë kaluar dy javë, kullojmë lulet e kamomilit dhe vajin e hedhim në një tjetër enë qelqi. Këtë përbërje ruajeni në një vend të freskët, ose në derën e frigoriferit. Këshillohet që të konsumohet një lugë gjelle esllë në mëngjes, të vazhdohet kështu derisa të ketë mbaruar përbërja.



# Hapen "Kutitë" e artistes bashkëkohore Tinamaria Marongiu

*Luigi Paolo Finizio: "Me mendjemprehtësi të patrembur dhe me këmbëngulje Marongiu ka si një qëllim më vete për t'u bashkuar në një ekzistencë të re"*

Ditën e enjte në Tiranë do të hapet ekspozita e artit viziv "Kutitë-TM"-Art Kompakt, e artistes bashkëkohore Tinamaria Marongiu, e cila ka sjellë një risi në artin viziv, kjo është një nga format e reja të shprehjes artistike të vlerësuara si një noçion dhe që është vlerësuar në disa bienale të ndryshme dhe aktivitete të rëndësishme artistike internacionale. Kjo ekspozitë do të hapet në galerinë e re të dedikuar artit kontemporan IICAS International Interactive Contemporary Art Space "TiranArtGalery", ditën e martë në datë 22 nëntor, që do të qëndrojë e hapur deri në dt. 7 janar. Kjo është ekspozita e tretë që do të hapet me punimet e artit bashkëkohor jofigurativ, duke synuar me këmbëngulje të hapë edhe për qytetin e Tiranës dritaren e artit më të fundit bashkëkohor. Në Tiranë në përgjithësi është më i kultivuar vetëm arti figurativ, i cili ka edhe vendin e tij në rrjetin artistik dhe komercial të qytetit, kështu që synohet edhe përkushtimi i një hapësire ekspozitive për artin jofigurativ dhe të gjitha format e evolucionit dhe të shprehjes artistike të tij. Galeria "TiranArtGalery" është një galeri e re në Tiranë.



Tinamaria Marongiu

Tinamaria Marongiu është njëkohësisht edhe themeluese e IICAS (Hapësirë Ndërkombëtare Interaktive Bashkëkohore e Artit) TiranArtGallery, objektivi i fondacionit është të jetë gjithmonë kujdesshëm për të kuptuar aspekte të rastit dhe jo të paracaktuar. IICAS TiranArtGalery ka lindur me vullnetin për të bashkuar njerëzit përmes çdo forme të gjuhës artistike. Një enë në të cilën për të jetuar momente të këndshme dhe pasurimit kulturor për përdoruesit, dhe ndërtimit gjithashtu, përmes shkëmbimit intelektual dhe krijues, për ata që kanë zgjedhur për t'i dhënë kuptim të ekzistencës së tyre duke bërë botën, mendimet dhe ndjenjat e tyre përmes një "veprimi" në Art. IICAS TiranArtGallery, një kalim i vazhdueshëm i informacionit artistik dhe gjuhëve të reja që gjejnë hapësirë dhe përhapje dhe veprojnë si një jehonë e ekzistencës sonë bashkëkohore. Realizuese e kësaj ekspozite është artistja italiane Tinamaria Marongiu.

**Janë shumë të vlerësuar veprat e paraqitura në këtë ekspozitë, nga kritikuri i mirënjohur i artit bashkëkohor, Prof. Luigi Paolo Finizio. Ai do të theksonte si më poshtë:**

"Me mendjemprehtësi të patrembur, dhe me këmbëngulje Tinamaria Marongiu me veprat e ekspozuara këtu, si një qëllim më vete për t'u bashkuar në një ekzistencë të re, dhe duke u bërë, si një mjet për "Box-es" kutitë ku qëndrojnë punët e saj. Për të kjo duket si një qëllim i saj që të kapë dhe konservojë në tiparet e jetës, më të larmishme dhe përreth realitetin e botës sonë organike dhe inorganike. Për ata që tashmë e dinë punën e saj krijuese, ose për ata që është hera e parë që ai e sheh atë, ekspozita afrohet me një rend të ri të kontejnerëve transparente në Plexiglas dhe Forex.

hë të reja ekspresive. Poezi, Fotografi deri në arrijtjen e Artit Visual. Ajo është autorja veprës objekt i poezisë vizuale "Arte Compatta" Box-Es, të cilën e ekspozon në mbarë botën. Në vitin 2011 ai u zgjodh për të marrë pjesë në Bienalen e Artit Bashkëkohor në Chianciano, ku ai fitoi Çmimin e Tretë për Artin e Aplikuar.

Teknika e përdorur: "Çdo kuti e mbyllur mban brenda një fragment të botës, një Syncretic e kombinuar me objekte dhe materiale, që të ndaluar në kohë për pamjen e tyre mes nesh, qëndrimin të tyre të vazhdueshëm dhe kalimtar

njëkohësisht, në evolucionin e jetës, të qenies së tyre në botë. Siç thuhet, "ato janë përfaqësime statike të qenies gjithmonë në ndryshim". Në bërjen e saj të artit, Tinamaria zbulon ndjenjat intime, këmbëngulje dhe është deklaruar për të bashkuar distanca, e



bashkuar në ndryshime, duke bashkuar ajo tenton të zhduket. Kështu, grumbulli i pajtueshëm i objekteve dhe materialeve plastike duke ndërftuar në një materie me ngjyra të ndritshme, njëkohësisht të errëta dhe diellore, por edhe aureole, përbëjnë grupe të mbledhura në imazhe solide. Vendos baza simbolike dhe morali të cilave, kuptimi i tyre do kor, është një mendim dominant që Tinamaria shtypur mbi to, të cilat mpikset në një njësi krijuese, lojën e tyre fantazi. Shpesh komplekset e materialeve, përzjerje e tyre e ngjyrave është shoqëruar me shënime, për mendimet që e bëjnë Box Ex-lafazane, me të cilin artisti shënon qëllimin komunikativ, përfshirë të menduarit Return vizuale. Dhe ka një prishje të kuti-së, të rregulluar dhe të organizuar të të dhënave kompozicionale, konstaton se edhe pse ajo tenton all'informe, gjendja e germimating nuk i jep formë në masë, për kontrollin hapësiror të kabinës transparente. Në spektaklin e tij joaktiv dhe mikroateatrik të gjërave të jetës."

plenary, thirrjes indiferente mbi gjërat e botës, gjërat e jetës për ta përkufizuar "Arti Compact", sikur ta nënvizionim parimin radikal të marrëdhënies që është e mbyllur në to. Qëllimi i mbledhjes dhe kujtesës që e nxit të jetë fizikisht në imazhin e tyre të plotë-trupëzuar, kushtetuta simbolike e kuti-së transparente. Ajo deklaracion çështjen korale, pafundësinë metaforike të vëlazërisë në sferën sociale."

Esenciale: "Në fakt, ne e dimë, në nevojën për të forcuar artin në jetë, marrjen e objekteve nga natyra, si dhe qarkullimi më i larmishëm i objekteve, gjetja e rastësishme ose parandaluese e materialeve, që duhet manipuluar dhe vendosur në punë, janë shumë të përdorura në praktikën e artit modern sot. Edhe nga kolazhet deri të bashkimet e ndryshme të materialeve dhe objekteve, arti është bërë përtej pikturës, e cila vazhdon ta zëvendësojë atë me ndërhyrjen e materialit heterogjen në materialin e jetës. Këto Box-Es janë një dëshmi tjetër krijuese, një gjest imazhi me të cilin artisti i drejtohet botës pyetjes së tij radikale të marrëdhënies, të ekzistencës së pandashme të përbashkët." Kritikë nga Prof. Luigi Paolo Finizio.

**Prerogativat themelore të nevojshme në art dhe në jetën shoqërore.**

Përmes një udhëtimi të gjatë të brendshëm dhe kërkimeve dhe një Master në Këshillimin Artistik të Ndërmjetësimit, ajo do ta zhvillojë kreativitetin e saj më shumë që do ta udhëheqë atë të afrohet dhe të përdorë gju-

Shfaqja e artit novativ: "Kohët e fundit, Tinamaria Marongiu donte të theksojë për veprat e saj një ndjenjë apeli



Dje në 'Deutsche Welle'

# Çfarë parashikon Brexit-i?

(vijon nga faqja 1)

...miratohet edhe në Londër. Marrëveshja për ndarjen mes Britanisë së Madhe dhe Bashkimit Evropian parashikon një fazë kalimtare deri në fund të vitit 2020. Gjatë kësaj periudhe Britania e Madhe do të ketë qasje në tregun e brendshëm të BE dhe nuk do të ketë dogana shtesë. Marrëveshja rregullon edhe të drejtat e qytetarëve nga të dyja anët, kërkesat financiare ndaj Londrës dhe çështjen e kufirit mes Irlandës së Veriut dhe Irlandës. BE i ka ofruar Britanisë së Madhe një lloj partneriteti "të ndershëm" ekonomik dhe politik.

Përfaqësuesi i BE në negociatat për Brexit, Michel Barnier, thotë se marrëveshja "është një hap i domosdoshëm për rikthimin e mirëbesimit mes BE dhe Britanisë së Madhe." Edhe pas Brexit, raportet mbeten shumë të ngushta: "Ne do të mbetemi partnerë dhe miq."

Presidenti i Parlamentit Evropian Antonio Tajani, thotë se edhe PE qëndron pas kësaj marrëveshje. "PE e mbështet këtë marrëveshje", thotë Tajani. Deputetët e PE do të debatojnë dhe votojnë për këtë çështje në janar dhe në shkurt. Pa-



keta e masave duhet të miratohet në PE dhe në parlamentin britanik. Në Londër deri tani nuk ka ndonjë shumicë

të qartë për këtë marrëveshje.

**"Marrëveshja për një të ardhme më të mirë"**

Para samitit BE-BM, kryeministria britanike May i ka dërguar një letër kombit të saj, me të cilën kërkon

mbështetje për marrëveshjen me Brukselin. Marrëveshja e respekton rezultatin e referendumit

dhe paraqet një bazë të mirë për "një fillim të ri dhe paqim", shkruan May. Marrëveshja duhet të miratohet nga parlamenti në Londër.

Marrëveshja është në interesin e kombit, si për kundërshtarët ashtu edhe për ata që mbështesin Brexit-in, pohon May. "Kjo është një marrëveshje për një të ardhme më të ndritshme, një marrëveshje e shanseve të reja." Parlamenti britanik do të votojë për këtë marrëveshje brenda disa javësh. May thotë se ajo do të angazhohet për këtë marrëveshje "me mish e me shpirt".

## "Plani B"

May i është drejtuar kohët e fundit disa herë përfaqësuesve të ekonomisë dhe opinionit britanik. Mediat britanike janë të mendimit se ajo në këtë mënyrë do të shtojë presionin ndaj parlamentit.

Krahas opozitës edhe konservatorët e ngurtë kanë paralajmëruar se do të votojnë kundër marrëveshjes. Për këtë marrëveshje do të votohet në BM në pjesën e parë të dhjetorit. Por gazeta "Sunday Telegraph" shkruan se diplomatët e BE dhe përfaqësuesit e BM janë duke përgatitur në mënyrë sekrete edhe një "Plan B", në rast dështimi të marrëveshjes së arritur në Bruksel.

## BalkanWebj.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Opinion i Ditës

# Demokracia liberale e kërcënuar nga një autoritarizëm i ri

Nga Vasil Kureta

(vijon nga faqja 1)

...e të drejtave të njeriut, zhvillimit ekonomik, politik e social, që ka në themel të saj sistemin funksional të vlerave, demokracinë institucionale funksionuese dhe sundimin e ligjit. Kjo epërsi është shkaku që është objekt i luftës e kundërvënies komplekse për interesa të ruajtjes së pushteteve autoritariste e diktatoriale, qeverisjeve të dështuara dhe interesat imperiale. Pikërisht, këto interesa janë dhe shkaku më kryesor i deklaramenteve prej tyre për fundin e demokracisë liberale apo dështimin e saj. Si çdo fenomen i gjallë edhe ky model i zhvillimit, ka në përmbajtje të vet një shumëllojshmëri problemesh e kontradiktash konkrete, që impulojnë edhe zhvillimin e avancimin e tij, që pëkin nevojën e përsosjes së mëtejshme, por që ka edhe sëmundje të brendshme e fenomene negative që e luftojnë së brendshmi. Aktualisht ka një rritje të shqetësimit për ardhmërinë e demokracisë liberale, siç ka rritje të hapave e veprimeve konkrete kundër saj, kundër rregullave të dakordësuara, normave e vlerave demokratike. Është fakt domethënës rritja e partive populiste në gjithë hapësirën europiane, përfshi dhe ato të ekstremit të djathtë, gjatë dy dekadave të fundit. Duke filluar nga viti 1998 nacionalizmi e populizmi janë rritur me shpejtësi, duke u shndërruar në një fenomen, që ka ngjallur shqetësim real. Projekti evropian është projekti më i madh, i mbështetur në sistemin e vlerave, që siguron zhvillim të qëndrueshëm, bashkëpunim e integrim, dialog e paqe, por që sot gjendet i kërcënuar nga revanshi nacionalist e populist, që godet thelbin e shpirtin e projektit. Mjaft dukuri e qëndrime, shërbejnë si ushqim për populizmin e që tronditin rëndë besimin e qytetarëve ndaj demokracisë liberale e institucioneve të saj. Dallgët e nacionalizmit mundësojnë fillimisht idenë e një dallimi mes anëtarëve të vjetër dhe atyre të rinj në BE, që shfaqin probleme në zhvillimin demokratik dhe respektimin e standardeve dhe rregullave të dakordësuara. Tash po flitet hapur për një përplasje mes forcave liberale e jo liberale brenda hapësirës europiane. Në një hapësirë të gjerë në botë sot konstatohet një rritje e qenies e rolit të vendeve me më shumë autoritarizëm, apo me qeverisje autoritariste e diktatoriale, ku spikasin drejtues me pushtet të fortë e të përqendruar personal, që godasin me rreptësi çdo kërkesë për standarde demokratike e mbrojtje të lirive e të drejtave të njeriut, që mbrojnë me dhunë pushtetin personal e të klanit të tyre. Ka sot shqetësim real se



populistët në të gjithë botën mund të rikthejnë tiraninë. Baza e këtij shqetësimi është fenomeni i marrjes së pushtetit me mjete demokratike apo deformim të tyre dhe më pas një sulm ndaj institucioneve demokratike, standardeve e principeve demokratike, sundimit të ligjit, lirisë e të drejtave të njeriut që i hapin rrugë rritjes së peshës e rolit të ekzekutivit mbi legjislativin, autoritarizmit e pse jo dhe të tiranisë. Tashmë ka formësuar përmbajtjen e vet dhe rolin, gjithashtu, një autoritarizëm i ri apo forma qeverisëse, që disa i kualifikojnë si demokraci jo liberale. Është bërë tepër shqetësuese dukuria e dhunimit dhe goditjes brutale të fjalës së lirë e shtypit të lirë demokratik, dhunimi e shtrembërimi i së vërtetës, i goditjes e vrasjes së gazetarëve e atyre që luftojnë për mbrojtjen e fjalës së lirë. Sot është prezent fenomeni shqetësues i një aleance, për të mos thënë simbiozë, mes drejtuesve pushtetesh me dorë të fortë e përqendrim të lartë të pushtetit, me korrupsionin e biznesin e ushqyer nga korrupsioni. Në hapësirën europiane dallgët e larta të nacionalizmit, populizmit e sovranizmit, po bëjnë presion në rritje e po godasin e gërryejnë bazamentin e modelit perëndimor të zhvillimit, sistemin e vlerave. Ka gjithashtu edhe prirje për formësim të aleancave mes këtyre forcave nacionaliste, populiste, autoritariste, ksenofobe e kundërshtarë të hapura të demokracisë liberale. Aktualisht, një problematikë e brëndëshme, tepër e mprehtë tërheq vëmendjen, për faktin, sepse atakojnë themelet e modelit, apo sëmurin shtylla të rëndësishme vitale të tij. Ka prirje e fenomene që synojnë deformimin e përmbajtjes së demokracisë, të frymës e përmbajtjes së saj, të bllokimit të funksionimit të institucioneve demokratike, të formalizimit të tyre apo të zbrazjes së për-


bajtjes demokratike të tyre, siç ka prirje të hapura të goditjes së pavarësisë së sistemit të drejtësisë dhe pengimit të sundimit të ligjit. Po kështu, në emër të prioritetit të ligjit dhe rendit po shfaqen tendenca të centralizimit të tepruar të pushtetit ekzekutiv. Ka prirje të rritjes së pasigurisë individuale e sociale, të grupeve konkrete sociale, që shërben si ushqim ideologjik për nacionalistët, populistët, euroskeptikët e për të dashuruarit pas autoritarizmit e pushtetit të përqendruar personal e të klanit etj. Autokratët e ndjejnë ngusht demokracinë, prandaj dhe godasin standardet e principet e funksionimit të saj, madje veprojnë ta asfiksojnë demokracinë e formalizojnë atë e institucionet e saj. Ata janë të dashuruar me dhunën, me dorën e fortë e dhe tërheqjen më shumë nga "unë" e jo nga "ne". Autokratët shfaqen të fortë, sfidues ndaj standardeve demokratike e ligjit, duke ngritur bllokada ndaj

tij, megjithatë, autokratët e kanë frikë të vërtetën, lirinë e shtypit dhe ligjin. Autokratët besojnë vërtet se "shteti jam unë". Spektri i antiliberalizmit po zgjerohet e po tentohet të zyrtarizohet përmes ligjeve që kufizojnë. Veprimi e fryma e antiliberalizmit është në zgjerim e ngritje të shpejtë. Po kështu, ka një rritje të ndjeshme të racizmit e ndarjeve racore, siç ka një prirje të polarizimit politik, por edhe pse jo të dukurive të konfliktit kulturor. Në horizont ka shenja edhe të fillimit të konflikteve sociale edhe pse realisht ka një mungesë totale të lëvizjes sindikale apo nga organizma të shoqërisë civile. Kriza e refugjatëve tregoi se si janë ringjallur koncepte e tendenca antihumane, që po infektojnë shtresa sociale. Këto dukuri e prirje janë ushqyer edhe nga efektet e krizave ciklike ekonomike, dështimit të reformave e politikave konkrete apo mungesa e reformave të domosdoshme, apo dhe nga reforma me frymëzime nacionaliste e sovraniste, mbyllëse. Ka sot në hapësirën europiane një rritje të dukshme të peshës dhe rolit të partive politike të ekstremit të djathtë, apo populiste, nacionaliste e euroskeptike, që kanë përfituar edhe nga legalizmi demokratik anti-institucional. Këtyre prirjeve anti-demokracisë liberale ju vinë në ndihmë edhe një problematikë e mprehtë sociale, ku treguesit e papunësisë e hendeqet e thelluara të pabarazive ekonomike e sociale e ulje e treguesve të nivelit të mirëqenies, kanë ndikim tepër të veçantë. Ka analizë sot, që fajësojnë për këtë problematikë, nacionalizmin e populizmin, por, në fakt, është problematika ekonomike e sociale e grumbulluar dhe e pamëshuar me efektivitet dhe gjeçja reale e ecurisë së projektit evropian, pa përjashtuar faktorët e jashtëm, që e kanë bërë të zëshëm nacionalizmin e populizmin. Ajo që bie në sy është fakti, se këto fenomene janë tashmë të shtrira në gjithë hapësirën europiane e jo të izoluar në disa vende të ish-lindjes komuniste, tashmë anëtarë të BE, ku janë evidentuar dukuri të cenimit të demokracisë liberale, sundimit të ligjit, që i ka shtyrë strukturat e BE të reagojnë e veprojnë, sipas rregullave të dakordësuara. Nisur nga ky fakt, disa analizat kanë shprehur shqetësim konkret për këto dukuri nacionaliste e populiste e antidemokracisë liberale, madje duke hequr edhe paralele me nacionalizmin e shfaqur në vitet 30 të shekullit të kaluar. Natyrisht, që ka sot një realitet të ri dhe konkret në përmbajtje. Analisti Leonid Berzhidski, nisur nga ky realitet i sotëm, për ta përcaktuar atë, përdor termin demokraci autoritariste →



◀ d.m.th. një realitet, që ka si element thelbësor ngushtimin e hapësirës së funksionimit të demokracisë liberale. Ky realitet ka një natyrë politike të tillë, ku demokracia liberale e institucionale, është cenuar e po cenohet rëndë nga filozofia, mendësi, politika e veprime, ndryshime juridike që frymëzojnë dhe krijojnë teren shumë për lëndën e autoritarizmit politik, që siç shihet mundësohet nga shfrytëzimi i demokracisë liberale. Në funksion të këtij autoritarizmi të ri, po shfaqet ajo që mund të quhet kulturë e patriotizmit. Nacionalizmi patriotik apo autoritarizmi patriotik, po marrin ushqim nga nacionalizmi, euroskeptizmi e populizmi, tërheqja pas interesave të shtetit komb e identiteti kombëtar. Natyrisht, që ky realitet e ky fenomen nuk mund të konsiderohet fatalitet, sepse kjo e ashtuquajtur demokraci autoritariste apo ky autoritarizëm i ri, ka si alternativën të përballet, duke e risjellë në shinat e saj reale demokracinë liberale ose në se nuk veprohet, atëherë i hapet rruga një qeverisje autoritariste apo diktatoriale.

Nisur nga një problematikë që po bëhet e mprehtë, mendohet se demokracia liberale po hyn në krizë, apo se demokracia po përjeton krizën, për faktin se nuk po di tu përgjigjet sfidave të kohës, apo problemeve të grumbuluara. Institucionet demokratike europiane nuk po dinë t'u japin përgjigjen e duhur shumë sfida-ve e jo vetëm krizës së refugjatëve dhe mjaft probleme, kanë prirje të agravohej, siç konstatohet dhe një prirje tensionimi të marrëdhënieve sociale e politike brenda vendeve europiane. Ka shumë shtyrje të zgjidhjeve të problemeve e shumë pak zgjidhje të tyre. Po kështu ka një krizë të përfaqësimit, e cila ushqen nevojën për njeriun e fortë, autoritar, që merr vendime të shpejta e në kohë të shkurtër. Deri më sot përmirësimet në qeverisje janë realizuar përmes zgjedhjeve demokratike, që kanë mundësuar zëvendësimin mes të majtëve e të djathtëve në qeverisje, që ka sjellë edhe një zhgënjim apo konsumim politik të ndjeshëm të partive të vjetra dhe një rendje pas partive të reja politike, që përdorin së shumti parulla populiste. Këto zhvillime kanë prodhuar gjithashtu edhe një dobësim të besimit ndaj demokracisë liberale e institucioneve të saj. Duket sikur është duke u formësuar një qëndrim, jo vetëm kritik, por dhe refuzues ndaj demokracisë liberale. Përplasja në zhvillim, mes qeverisë populiste italiane e strukturave të BE,



që kërkojnë respektim të rregullave e principeve të dakordësuara, është një dëshmi konkrete e këtyre zhvillimeve. Nënveftësimi i këtij realiteti të sotëm e mosreagimi i mirëmen- duar e i vendosur, nuk është alternativë, madje është pa- përgjegjshmëri për klasat politike europiane, por mungesa e një strategjie të kompletuar është fakt. Ndjehet rritja e shqetësimit, por duket se nuk është kuptuar sa duhet rreziku kërcënues. Presidenti hungarez Orban, duke iu referuar trysnisë së emigracionit në hapësirën europiane dhe në emër të "mbrojtjes" së identitetit europian, mendon se emigracioni ka prirje të shndërrojë në pakicë europianët vendas. Dhe në funksion të tërheqjes së vëmendjes, apo si "argument", duke e identifikuar emigracionin me terrorizmin, po- hon se terrori do të bëhet pjesë e jetës në qytetet më të mëdha. Ky arsyetim është më shumë i nxi- tur nga nacionalizmi e jo nga sistemi i vlerave e filozofia e pro-

jektit europian. Demonët e nacionalizmit sot po shfaqen, jo si fantazmë, por si veprim e kërcënim serioz ndaj demokracisë liberale e sistemit të vlerave, ndaj modelit perëndimor të zhvillimit. Ka sot prezencë një prirje e tensionimit të marrëdhënieve sociale e politike, që po i jep ekzistencë edhe një pasigurie komplekse në rritje, për punën, për jetën, për të ardhmen, që nacionalistët e populistët përpigjen ta paraqesin si pasiguri nacionale. Dhuna e fundit e shfaqur në zëmër të Parisit, nuk mund të shihet as si rastësi e as të nënveftësohet. Presidenti Makron ka reaguar duke pohuar: "Turp për ata që sulmuar forcat e sigurisë, turp për ata që ishin të dhunshëm ndaj qytetarëve dhe gazetarëve". Kuptohet elementi moral, por ai demonstrim nevojitet të lexohet plotësisht e në thellësi. Tash duket se është pjekur shumë nevoja e një programi kompleks e të plotë, që mundëson, si mbrojtjen modelit europian të zhvillimit, të demokracisë liberale,

por dhe e përsos atë më tej. Kjo nevojë ka filluar të kuptohet tashmë. Presidenti Makron me të drejtë ka evidentuar atë që nevojitet shumë në këtë moment: "Europa, dhe në të cifti gjermano- francez, ka detyrimin, që të mos e lërë botën të rëshkasë në kaos". Por siç ka nënvizuar presidenti gjerman Steinmeier, për përbalimin e një problematike komplekse, në mbrojtje të demokracisë liberale dhe avancimi të saj, nevojiten para së gjithash ide të reja. Një kuptim i thellë e i plotë mund të realizohet duke u udhëhequr nga filozofia e projektit europian dhe sistemi i vlerave. Natyrisht, një strategji konkrete, që do të mundësonte një luftë efektive ndaj kësaj forme të autoritarizmit apo deformimit e cenimit të demokracisë liberale, që do të për- soste e modernizonte më tej modelin europian e demokracinë liberale, është e domosdoshme, por që do të kërkonte njohjen e thellë e të plotë të shkaqeve, që e sollën dhe përcaktimin e rrugëve efektive të zgjidhjes së problemeve.

**BLUE TOOTH**

THASHETHEME MADE IN ALBANIA

te rejat nga jeta

**Vipave**

çdo të shtunë falas me

### HOROSKOPI

#### DASHI

Ka gjasa që t'ju duhet të përfundoni një projekt shumë të rëndësishëm pa ndihmën e askujt. Ndërsa jashtë pune do të kaloni një ditë shumë të këndshme. Do të merrni një lajm shumë të mirë nga njeriu juaj i zemrës.

#### DEMI

Do të jeni të fokusuar në një çështje të rëndësishme për jetën tuaj, ndërsa gjithçka tjetër do ta lini jashtë vëmendjes. Mund të krijoni një lidhje të re romantike. Megjithatë nëse duhet të përfundoni paqetë diçka në punë, merreni seriozisht atë.

#### BINJAKET

Dikush do të kërkojë mendimin tuaj për stilin e të veshurit dhe do të vlerësoheni për këtë. Kushtojni rëndësi disa çështjeve që kanë lidhje me pasuritë e pa- tundshme. Ekziston mundësia që sot të gjeni opinionin e duhur.

#### GAFORJA

Mund t'ju duket sikur jeni kthyer sërish në bankat e shkollës. Ndoshta mund të nisni trajnimet për të kuptuar disa aplikime dhe kërkesa të reja në punë. Pjesa tjetër e ditës do të jetë e qetë dhe e zakonshme.

#### LUANI

Do t'ju përfshijë rutina dhe do ta kenë të pamundur të dilni prej saj për të realizuar ato çfarë dëshiro- ni. Do të kaloni një pasditë të lodhshme. Do të bënit mirë të gje- ni një moment për t'u relaksuar, pasi do ta kenë të vështirë të nis- ni ditën e nesërme.

#### VIRGJERESHA

Mos prisni rezultate shumë të mira sot, dhe duhet ta pranoni këtë. Për një arsye të caktuar, nuk do të mendoni për situatën tuaj aktuale, por do të ëndërroni. Nuk mund ta kaloni kohën në këtë mënyrë, mbi të gjitha kur e ardhmja juaj në karri- erë është vendosur tashmë. Partner/part- nerja do t'ju ndihmojë të relaksoheni.

#### PESHORJA

Do të gjeni një mundësi për të ndaluar një pabesi nga dikush sipër jush në punë, ndoshta nga shefi juaj. Nëse kjo është hera e parë që ndodh, mos e zmadhoni si situatë. Trajtojeni këtë situatë me qetësi pasi në të kundërt mund të jetë edhe dita juaj e fundit në punë.

#### AKREPI

Disa persona të kësaj shenje mund të arri- një qëllimin e tyre. Duke u përpjekur të realizoni planet tuaja, do t'ju mbrojnë ndaj veprimeve cinike, por nga ana tjetër mund të ndikojë negativisht edhe ndaj dikujt. Sinjerteti juaj do të mirëpritet si në punë ashtu edhe në çështjet personale.

#### SHIGJETARI

Shumë persona të kësaj shenje do të jenë të mburur plot energji këtë të hënë dhe presin javën me entuziazëm. Foku- sohuni tek mënyrat për të pasur një kar- rierë të suksesshme. Vetëm duar e përp- jekur mund të arrihi rezultate të mira.

#### BRICJAPI

Do të ndiheni shumë mirë emocionalisht. Do të shikoni gjithçka me vëmendje në jetën tuaj dhe do të vlerësoni ato që kenë arritur deri tani. Nëse është e mundur, do të ishte mirë që sot të fokusoheshit më së shumti tek planet sesa thjesht të bësh punën e ditës.

#### UJORI

Ndoshta nuk është në natyrën tuaj të ndiq- ni turmën, por sot do t'ju duhet absolutisht të fokusoheni tek punët tuaja. Ka gjasa që të bëni disa ndryshime në stilin tuaj të jetesës. Përpunoni të gjeni edhe pak kohë për vetën, mbi të gjitha për të lexuar apo për të kryer aktivitetet që ju dëshironi.

#### PESHQI

Kjo e hënë mund të jetë fillimi i disa reformave të mëdha në disa çështje të rëndësishme të jetës suaj. Ndëqin in- stinktet tuaja lidhur me këtë dhe mos shpërfilini këshillat e të afërmeve, pasi do t'ju ndihmojnë në marrjen e vendi- meve.

PORTIERI I PARTIZANIT

Pas lajmit të bujshëm për arrestimin e portierit të Partizanit, Alban Hoxhës, nga Partizani, vijmë edhe detaje të reja. Ai është arrestuar në orët e para të mëngjesit të sotëm, dhe pritet të dalë për masë sigurie në gjykatë ditën



e martë, për të mësuar nëse do të qëndrojë në paraburgim, nëse do të marrë masën "detyrim paraqitje", ose arrest shtëpie. Siç publikoi "Panorama", në testin e alkoolit Alban Hoxha ka rezultuar në masën 0.52 miligramë për litër, ndërsa norma e lejuar është 0.30 miligramë për litër. Ja edhe njoftimi i policisë, për arrestimin e Alban Hoxhës, i

Drejtonte mjetin në gjendje të dehur, arrestohet Alban Hoxha

cili është kapur në rrugën "George W Bush", gjendur pranë parlamentit, dhe gjendet në Komisaratin 1. "Policia Rrugore arreston në flagrancë tre shtetas për drejtim mjeti nën efektin e alkoolit. Nga shërbimet e Policisë Rrugore u arrestuan në flagrancë sh-

"Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt", parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal". Kjo nuk është hera e parë që portieri i Partizanit përfundon në situatë të tillë. Pak vite më parë është përfshirë në një sherr në një lokal në ish-bloq, ndërsa sezonin e shkuar është aksidentuar me makinën e tij, duke marrë dëmtime të lehta.

Verilindorët fitojnë ndaj Kamzës që shënoi dy herë në portën e vet



Jeton Selimi

# Kukësi, fitore autogolash Laçi ngjitet në vendin e tretë

Kurbinasit vuajnë ndaj Kastriotit, por marrin 3 pikët

90 minutat e javës së 14 kanë rikthyer Laçin dhe Kukësin te tri pikët. Kurbinasit kanë festuar në fund, pasi kanë shënuar në kohën shtesë për të regjistruar rezultatin 2-1 kundër Kastriotit, ndërsa Kukësi ka mbyllur gjithçka në pjesën e parë duke fituar 0-2 kundër skuadrës së Ernest Gjokës.

**FITORE AUTOGOLASH**

Në Kamzë pritet një ndeshje e luftuar fort dhe kështu ishte deri në minutën e 25, më pas Kukësi krijoi më tepër shanse për të shënuar dhe e arriti që të gjente rrjetët pas një gabimi të mbrojtësit Frashëri të skuadrës kamzale. Korçari i Kamzës në pamundësi për të larguar topin me kokë jashhtë vijës së 16 metërshit, e dërgon atë në rrjetën e portierit Kiriev. Autogoli i parë i dha goditje të rëndë psikologjike skuadrës së Ernest Gjokës, i cili debutoi sot në këtë pankinë. Ndërsa si të mos mjaftonte kjo, Teqja në minutën e 33 shënoi sërish në portën e tij. Kukësi e pati më të lehtë të administroonte lojën në pjesën e dytë, teksa Armando Cungu më së



miri kontrollon të tijtë duke mos lejuar pësim golash. Kukësi rikthehet sërish te fitoret dhe te gara për një

vend në kreun e tabelës.

**LAÇI I TRETË**

Kurbinasit riktheheshin në fushën e tyre pas dy muajsh,

ku arritën që të bënin fitore të vështirë, por marrin tri pikë me vlera për garën për Europën. Pjesa e parë ishte

SUPERLIGA		
JAVA E 14-TE		
<b>TË PRËMËNTEN</b>		
Flamurtari-Partizani		1-0
<b>TË SHËTUNEN</b>		
Tirana - Skënderbeu		1-1
Teuta - Luftëtari		1-0
<b>TË DIËLEN</b>		
Kamza - Kukësi		0-2
Laçi - Kastrioti		2-1
<b>RENDITJA</b>		
Skuadra	N	P
Partizani	14	31
Skënderbeu	14	30
Kukësi	14	24
Laçi	14	25
Teuta	14	25
Flamurtari	14	22
Luftëtari	14	13
Tirana	14	11
Kamza	14	8
Kastrioti	14	7

dytë volumi u rrit nga ana e Laçit, që në minutën e 61 me Altiparmakovskin arrinë që të çojnë topin në rrjetë, 1-0 dhe entuziazmi shpërtheu te kurbinasit. Veç kësaj, me Xhixhën pak minuta më vonë patën shansin që të dyfishonin rezultatin, por që nuk u tregua i saktë djaloshi nga Laçi. Megjithatë, një aksion i rrjedhshëm i Kastriotit në zonën e Laçit sollti dhe golin e barazimit në minutën e 70 me Ymerajn. Më tej ekipi krutan shkoi shumë pranë kalimit në avantazh, por Laçi me freskimet e lojës arriti që të krijojë më tepër volum dhe raste shënimi. Gjithnjë në fund, fati ishte me kurbinasit që me anë të Xhixhës çuan topin në rrjetë, 2-1 dhe kështu konkretizojnë tri pikë me mjaft vlera për luftën për një vend në katërshen e parë.

pothuajse e balancuar me krutanët, skuadër që i vuri në vështirësi në disa raste bardhezinjtë. Në pjesën e

TRAJNERI I KAMZËS

## Gjoka: Jam i zhgënjyer nga kjo humbje

Trajneri i ri i Kamzës, Ernest Gjoka debutoi me humbje në krye të pankinës dhe përballë Kukësit në shtëpi, skuadra e tij u mposht 0-2. Për "Supersport", Gjoka foli pas ndeshjes, ku u shpreh shumë i zhgënjyer me mënyrën si erdhi kjo humbje: "Ndjej keqardhje për futbollistët, pasi ata e vuajnë më shumë që të bësh autogol në një ndeshje që të paktën, nuk duhej të kishim humbur. Rasti i penalltisë? Nuk kam çfarë mendoj, nuk kam mirë se kaq. Këtu ishim 0-0 dhe nëse do të

jepej kjo penallti, do të kishim tjetër agresivitet, e megjithatë, arbitri e di... Nervozizmi? Ka nervozizëm sepse nuk është kollaj që të jesh në vendime fundit. Po mendojmë që të ndryshojmë këtë gjë pasi me nervozizëm nuk shkohet askund. Nuk ishte nervozizëm por ishim pa fat te goli. Duhet sqaruar nervozizmi. Kam gjetur ekip në vendin e fundit, por me cilësinë që kanë duhet të ishin pak më lart. Janë në moment shumë të vështirë. Objektivi ynë është të marrim pikët dhe kjo është diskutuar gjatë gjithë kohës. Do

të jemi në kërkim të pikëve pasi ky është një test për të gjithë ne. Sa më shumë pikë merr, aq më i qetë je, në të kundërt je i stresuar. Merkato? Çështja kryesore është të dalim nga ngërçi ku jemi. Janë edhe 4 javë dhe ne duhet t'i kalojmë duke marrë sa më shumë pikë dhe ky është objektivi i vetëm. Nuk mendojmë asgjë tjetër. Për cilësinë që ka Kamza, nuk duhet të jetë në këtë vend, por duke humbur do të thotë se humb qetësi duke humbur pikë e më pas nuk ke asgjë në vijë".

Trajneri i Kukësit shtaqet diplomat

## Cungu: Nuk ishte aq e lehtë sa dukej


Trajneri i Kukësit, Armando Cungu, pas fitores me Kamzën ka theksuar se autogolat erdhën nga fakti se skuadra e tij bëri presion të lartë. Ai evidentoi veçanërisht lojën e Çyrbjes, ndërsa për episodin me Rexhinaldon ka dashur ta anashkalojë me diplomaci. **E kishe menduar një fitore kaq të thjeshtë?** Ishim përgatitur për ndeshje të luftuar dhe të fortë. E theksova që dje që Kamza ka kualitet në ekip. Terreni është pak i ngrohtë dhe nuk na priste ndeshje e lehtë. Çyrbja meriton komplimente, por edhe të gjithë djemtë. Pjesën e dytë ishte dicka tjetër. **Episodi me Rexhinaldon?**

Nuk ka asgjë për t'u shqetësuar, ishte vetëm një keqkuptim, dicka kalimtare. Nuk duhet të diskutohet. **Sa i kënaqur jeni që keni ndërruar formacionin?** Për sa i përket modulit, duke parë edhe mungesat jo të vogla, ishim pothuajse gjysmë ekipi, prandaj erdhi. Kërkoja më siguri mbrapa. Lojtarët e ekipit të Kamzës kanë kualitet përpara. Sistemi nuk është vetëm mbrojtës, por edhe shumë sulmues. Do ta kisha dëshiruar 0-3, por është e rëndësishme që ekipi di të menaxhojë lojën. Mund të kalohet në eufori dhe duhet të

ishim serioz. Një gol i Kamzës do të vinte në diskutim rezultatin. **Ku duhet të ndërhyri në merkaton e janarit?** Na vendosni shumë në vështirësi me këto pyetje. Do të thosha që jam i fokusuar te këta djem dhe për t'i marrë maksimumin. Ka vend për përmirësim. Nuk e di sesa mund të jenë efikase, sepse janë të vështira. Edhe me grupin që jam do të luftojmë deri në fund. E kam theksuar se Kukësi nuk ka marrë atë që ka shprehur në fushën e lojës. Nuk është pak mos të luash në fushën tënde.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

- Një pije freskuese.
- Graf ish teniste.
- Dada, ish-diktator i Ugandës.
- Eshhtë pasuri e investuar.
- Mund të jenë fetare.
- Një pjesë e relacionit.
- Fillojnë ambalazhimin.
- Një vegël.
- Qe harkëtar i famshëm i akejve.
- Fillojnë hetimin.
- Një atentator vëtvrasës.
- Kështu janë takimet zyrtare.
- Eshhtë anije me dy skafë.
- Fundi i Turandot.
- Inicialet e Reitman regjisor.
- Farrell regjisor.
- Schneider që qe aktore.
- Mund të jetë e lirë për hartim.
- Emri i Pasternak.

- Ekberg e La dolce vita.
- Dikur qubej Mediolanum.
- Ruajnë pa ujë.
- Një mund të jetë kalendari.
- Një është meskini, shpirtngusht.
- Një hidrokarbur.
- Mund të jetë franceskan.

**VERTIKAL**

- Jessica Parker aktore.
- Zola shkrimtar.
- Janë dritë të tilla me parsec.
- Mund të jenë gjaku.
- United Kingdom.
- Eshhtë njeri me principe.
- Një polimer për kirurgji estetike.
- Kufizojnë takimet.
- Diftong teatral.
- Fillojnë fluturimin.
- Makina Uno.
- Eshhtë shpend lagune.
- Eshhtë operator që bën zoom.
- Eshhtë i pashpirt.
- Parashtesë për një.
- Pak enigmatike
- Një pjesë e Toskërisë.
- Agustini ish-bomber.
- Kufizojnë një princip.
- Miku i Batman.
- Tapeti për judo.
- Janë stadet në videogame.
- Bëhet një kundër vendimit.
- Janë me blerim mbuluar në një film
- Eshhtë shtet aziatik.
- Papavrami violinist
- Fadili komik
- Përshëndetja e Jul Qezarit.
- Mbyllin fushatat.
- Me të bëjnë një ketër.
- Mbyllin një takimim.

**Fjalëkryqi (2)**


**HORIZONTAL**

- Një pemë gjigante.
- Janë për të kërcyer.
- Ishtë shkollë e Aristotelit
- Një thirrje me emra.
- Gjysmë rivale.
- Një pjesë e narkotikëve.
- Një tis... mjegulle
- E famshme ajo e Keopsit
- Mbyllin një sirtar
- Eshhtë ngjyrë e... fytyrës.
- Fillojnë lejen.
- Janë aktorë kryesorë.
- Janë kompozime të kënduara.
- Hudson aktore.
- Satelit i Uranit.
- Fillojnë tatëpjepën.
- MBetur në fund.
- Sapo fillojnë.
- Kastile janë në fund.
- Kufij takimi.


- Ekstremet e tokës.
- Inicialet e Einstein.
- Qendër mësimi.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Pak irredentizëm
- Fundi i një filmi.
- Popullojnë qytetin.
- Janë gojë vulkanesh
- Eshhtë edhe ai Persik.

**VERTIKAL**


- Mund të jetë sekrete në derë.
- Makina Agila.
- Ami i Maupassant.
- Mbyllin një sirtar.
- Rrëzohen me strike
- Luciano tenor i paharruar.
- Mbyllin këndet
- Eshhtë borxh.
- Mbyllin portat.
- Hagen rockstar.
- Një pjesë e akademisë.
- Bien me ballë.
- Një barkë lëkurëkuqsh.
- Atje ku shkon progresisti
- Pallati i Dalai Lamas në Lhasa
- Një pjesë e minoritetit.
- Eshhtë fluturues në ufo.
- Do të bëhen mace të tilla.
- Fletë pa kufij.
- I ka tek rendi.
- Kreshniku i volejbollit.
- Një det që është liqen në fakt.
- As unë, as ai.
- Në mes të King edhe Cole të muzikës.
- Një parashtesë zmadhuese.
- Eshhtë Ion papagalli.
- Titulli i Sean Connery.
- Fillojnë panikun.
- Gjysma e rojave.
- Fitim pa kufij.
- Mbyllin një sherr.
- Fillojnë një metodë.
- Kufizojnë botimet.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

1		9				2	5	
				7		6		3
	2			1		8		
3	5	6			4		9	
		2	9	8				
8						5		
	6	1	3					5
		3	7					6
5				6				

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

7	3	5	2	4	6	9	8	1
6	8	9	7	3	1	5	2	4
4	1	2	9	5	8	3	6	7
2	4	6	1	9	3	8	7	5
3	5	7	4	8	2	1	9	6
1	9	8	5	6	7	2	4	3
8	6	1	3	7	9	4	5	2
9	2	4	6	1	5	7	3	8
5	7	3	8	2	4	6	1	9

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

*Argëtim filozofik*

-Gjithësecili dëshiron t'i shohë njerëzit e mëdhenj, por më mirë është të shohësh veprat e tyre, d.m.th. të shohësh ata vetë, sepse idetë e tyre s'kuptohen nga fytyrat e tyre, por dallohen nga veprat e tyre.

-Kush nuk merret vesh me vëllanë, s'merret vesh fare me bashkëqytetarët e tij.

-Njeriu të mos ketë frikë nga ligji, të ketë turp nga bota, të ketë frikë nga ndërgjegjja e tij.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

8	A	1	11	16	7	5	15	8		3	8		
1	Z	8	13	8	6		6	8		4	3	8	12
2	I	7		10	8	9	2		15	2	11	3	2
9	L	14	8	12	17	12	3	7	9	9	2		
	5	7	15	5	8	5	2	16	8	5		16	
4	8	6	5	2	15	8		7	15		10	7	
7	5	7		12	7	15		6	11	6	5	15	
5	6	4	7		5	2	18	2	11	19	7		
5	4	11	6	19			9	8		4	8	6	
9	11	15		1	7	5	8		19	8	1	8	
7	6	2	14		14	7		16	11	15	7		
5	7	8	4		8	9	3	8	15	7	5		

K	U	L	T	M	A	P	L	A	B		
O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R	
R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E
B			K	L	E	O	P	A	T	R	A
I	E	K	I	T	R	E	T	E		S	
L	A	M	E	K	E	R	M	A	T		
T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E	
O	T	O	S	C	I	R	M	A			
B	R	E	D	H	I	A	I	R	K		
I	L	E	I	N	E	P	H	I	L		
A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I
S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQIVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	K	U	T	E	R	I		T	I	M			
A	G	A	R	R	E	N	D		M	I	K	E		
L	I	T	A	R	E	T	E	S	O		R	I		
E	M	I	L	E		A	P	E	L	I	T	M	I	
A	E	L	E	D	E	P	O	Z	I	T	A	T		
A	T	E	K	A	P	A	N	O	N	E	T			
L	E	S	S	E	K	A	N	A	R	I	N	E	A	M
E	S	S	E	K	A	N	A	R	I	N	E	A	N	A
C	I	F	A	N	M	I	T	E	E	M	E	R	I	
M	I	K	A	T	E	T	E	T						
K	O	R	I	K	U		K	O	L	L	A			
U	N	A	Z	A	R	E	N	D	O	R	E			
M	I	R	A	N	D	A	B	E	I	S	H	I	T	I
I	R	A	A	R	M	A	D	H	I	D				
T	O	A	P	A	R	A	T	E	T	E				
I	N	R	I	M	O	T	E	T	U	M	A			
I	R	D	A	M	A	R	E	T	I	L				
I	A	K	O	T	A	N	I	O	D					
M	K	A	B	I	N	E	T	E	R	A	R			
P	U	R	T	E	K	E	E	T	N	I	K	E		
P	E	R	S	E	T		I	N	T	I	M			
L	A	O	I		G	O	L	A	L	A				
I	H	R	T		P	E	T	E	R	I	K			
V	O	L	E	E		L	E	N	D	E				

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- Mendojmë se njeriu vdes dhe shkon, mirëpo të vdekurit janë ata që edukojnë fëmijët tanë, që na mësojnë dituritë dhe shkencat, kur marrim në dorë një libër dhe e lexojmë në vetmi në një çip dhe, sipas rastit, ata na bëjnë të qeshim apo të qajmë.
- Ai që pranon këshilla, është më i madh se ai që jep, sepse,
- sa lehtë është të japësh këshilla. aq rëndë është t'i pranosh.
- Dyshimi është gur argjendari i së vërtetës, kush dyshon në marrëdhëniet e përditshme, s'gabon asnjëherë, kush dyshon në veprimet e veta, bëhet filozof.

